



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 46 regjistër (JR)
Datë 23.08.2021

Nr. 47 i vendimit
Datë 14.10.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 14.10.2024, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 46/2021 (JR), datë 23.08.2021, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Luveda Dardha, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 398, datë 11.06.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Luveda Dardha.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 1, 2, 63, 64 dhe neni 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e ngritura në ankim dhe në parashtrimet e datës 26.09.2024 të subjektit të rivlerësimit, e cila kërkoi gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ndryshimin e

vendimit nr. 398, datë 11.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, dhe e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Luveda Dardha (referuar në vijim “subjekti i rivlerësimit” dhe/ose “subjekti”) ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Duke qenë se ushtronte këtë funksion në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, ajo u përfshi në rrethin e subjekteve që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* dhe iu nënshtrova këtij procesi, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

1.1 Sipas parashikimeve të nenit 31, pika 1, nenit 35, pika 1 dhe nenit 41, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”) në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

1.2 Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga institucionet e mësipërme, ILDKPKI, DSIK dhe KLGj, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilave:

(i) ILDKPKI-ja¹ ka konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- dokumentacion jo i plotë ligjor për të justifikuar burimin financiar të huadhënies nga babai;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

(ii) DSIK-ja², në një raport të parë të figurës, ka evidentuar *përshtatshmërinë* e subjektit për vijimin e detyrës. Pas një informacioni të dërguar nga instancat përgjegjëse, grupi i punës ka ndryshuar konstatimin fillestar, nga *përshtatshmëri* për vazhdimin e detyrës në *papërshtatshmëri*.

(iii) KLGj-ja³ ka rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

2. Komisioni, me vendimin nr. 398, datë 11.06.2021, me shumicë votash, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në konkluzionet që vijojnë:

¹ Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 13.04.2019.

² Dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 09.04.2021, e deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 09.04.2021, të KDZh-së.

³ Shkresa nr. {***} prot., datë 03.011.2020, e KLGj-së, “Raport për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Luveda Dardha – për periudhën 08.10.2013 – 08.10.2016”.

2.1. Për kriterin e kontrollit të pasurisë, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me burimin e krijimit të pasurive dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e tyre, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

2.2. Për kriterin e kontrollit të aftësive profesionale, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel *kualifikues*.

2.3. Për kriterin e kontrollit të figurës, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve të subjektit, Komisionit iu krijua bindja se informacionet që disponoheshin në ngarkim të saj, sipas kërkesave të germave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ishin të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete. Sipas Komisionit, edhe nëse ky konkluzion nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në një përfundim lidhur me kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, mospërmblidhja e rregullt e detyrës cenon pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Luveda Dardha dhe shkallën e besueshmërisë së saj, referuar pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit dhe pretendimet e subjektit në ankim

3. Kundër vendimit të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, e cila kërkoi: (i) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (ii) ndryshimin e vendimit të Komisionit; dhe (iii) konfirmimin në detyrën e gjyqtarit. Pretendimet e subjektit, grupuar sipas natyrës, përmbliidhen në vijim.

3.1. Në lidhje me procesin e rregullt ligjor:

(i) Nuk është respektuar parimi i ligjshmërisë, i drejtësisë dhe paanësisë, i barazisë para ligjit, i proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe i të drejtës për një procesi të rregullt ligjor. Sipas subjektit, shkelja e këtyre parimeve nga Komisioni solli një përfundim të gabuar mbi vlerësimin e pasurisë dhe të figurës, përmbyllur me konkluzionin tërësor se *është cenuar besimi i publikut te drejtësia*.

(ii) E njëjta trupë gjyqësore e Komisionit ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga qëndrimi që ka mbajtur në gjykimin e çështjes së saj në vendimin nr. 342/2021⁴, duke ngritur dyshime serioze për qëndrim paragjyqës, subjektiv dhe të pabazuar në prova, si dhe duke deformuar faktet ku është bazuar vendimi.

(iii) Shkaqet e tjera procedurale janë ankimuar, lidhur me mënyrën e vlerësimit të kriterit të pasurisë dhe figurës, dhe gjejnë shtjellim në pjesët përkatëse të arsytimit.

a) Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti pretendon se:

3.1. Për *apartamentin* e banimit në Tiranë, subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë e të pamjaftueshëm. Vlera e deklaruar prej 28.000 eurosh pasqyron detyrimin e mbetur ndaj huadhënësit në kohën e paraqitjes së deklaratës *vetting* dhe jo vlerën totale prej 36.000 eurosh të huas. Diferenca prej 8.000 eurosh është shlyer nëpërmjet disbursimit të pjesës së dytë të kredisë. Për këtë shkak, ajo nuk gjendet në kushtet e pasaktësisë apo pamjaftueshmërisë, pasi e ka deklaruar këtë fakt në deklaratën *vetting*, në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2016 dhe ky element evidentohet edhe në kontratën e huas.

⁴ Ky vendim i Komisionit, i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elbana Lluri.

3.2. Për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë:

3.2.i. Mospërfshirja e të ardhurave të prindërve nga aktiviteti i shitjes ambulante nuk është logjik. Gjithashtu, subjekti kundërshton edhe konkluzionin e Komisionit për shlyerjen e detyrimeve tatimore të punës së prindërve si shitës ambulantë përgjatë viteve 1993-2001, duke pretenduar se ky detyrim nuk sanksionohej nga ligji i kohës. Sipas saj, të ardhurat nga aktiviteti tregtar i prindërve në vitet 1993-2001 kanë qenë në vlerën 56.000 USD, të depozituar në Bankën Amerikane në vitin 2003, e të tërhequra në vitin 2004 për të prenotuar apartamentin [që u ble në vitin 2006]. Ndërsa, diferenca midis vlerës totale dhe vlerës së dhënë hua subjektit u mbajt në banesë nga prindërit për një investim të mundshëm, që nuk u finalizua.

3.2.ii. Analiza e Komisionit, për të ardhurat nga shitja e dy pasurive të paluajtshme në pronësi të prindërve, si burim i huadhënies, është në kundërshtim me pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe me qëndrimin e Kolegjit në vendimin (JR) nr. 15/2019⁵. Komisioni nuk mund të kontrollojë mënyrën e përfitimit të të ardhurave nga shitja e dy apartamenteve, për të blerë një apartament shumë kohë para fillimit të detyrës së saj, pasi tejkalon qëllimin e pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Hetimi duhet të ishte kufizuar vetëm në mundësinë e krijimit të të ardhurave dhe nëse ishin paguar detyrimet tatimore. Analiza financiare e prindërve, sipas dispozitës së sipërcituar, tregon mundësinë e tyre për t'i dhuruar asaj vlerën 36.000 euro në vitin 2016.

3.2.iii. Për vlerën 2.000 euro, që shërbeu për shlyerjen e këstit të fundit pasurisë, subjekti pretendon se tepricat e të ardhurave gjatë viteve 2012, 2013 dhe 2014, nga jetesa e përbashkët me prindërit i ka përdorur për shpenzimet e jetesës. Meqenëse u përdorën tepricat e viteve për të përballuar shpenzimet, iu krijua mundësia për të disponuar/kursyer likuiditetet në vlerën 2.000 euro në datën 24.08.2016. Subjekti kërkon që të përfshihen në analizën e të ardhurave edhe dietat dhe shpërblimet e bashkëshortit, që, sipas saj, do të ulnin balancën negative për periudhën 2012-2016, në masën (-) 825.061 lekë.

3.3. Për automjetin e parë, tip "Daimler Chrysler", prodhim i vitit 2002, blerë në janar të vitit 2015, subjekti pretendon se Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës në relacionin e hetimit administrativ, për t'i kërkuar shpjegime për burimin e krijimit në deklaratën *vetting*. Në kohën e plotësimit të deklaratës *vetting*, nuk e dispononte pasurinë që shërbeu si burim i shlyerjes së vlerës së automjetit që bleu në qershor të të njëjtit vit. Në deklaratën *vetting*, ajo kishte detyrim të deklaronte burimin që shërbeu për blerjen e mjetit aktual ["Daimler Chrysler", prodhim i vitit 2003] dhe jo të shpjegonte burimin fillestar, të cilin e kishte përmbushur në deklaratën periodike. Vlera e marrë hua nga prindërit nuk ishte 336.000 lekë sa është deklaruar, por 100.000 lekë. Deklarimi i vlerës 336.000 lekë ka qenë një gabim nga bashkëshorti.

3.3.i. Për automjetin tjetër [tip "Daimler Chrysler", prodhim i vitit 2003], blerë në qershor të vitit 2015, mori hua nga prindërit dhe e deklaroi pasurinë në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2015 dhe nuk kishte detyrimin të deklaronte marrjen e huas dhe shlyerjen e saj prindërve me të ardhurat e krijuara brenda vitit. Prindërit e kanë financuar huan e dhënë asaj me të ardhurat nga aktiviteti tregtar i shitjes ambulante dhe të ardhurat nga shitja e dy pasurive të paluajtshme, që ishin pjesë e vlerës totale të kursyer prej 56.000 USD.

3.4. Për të ardhurat nga shitja e tokës në Velipojë, Shkodër, subjekti pretendon se pasaktësia e deklaratimit të pasurisë nga bashkëshorti nuk mund të sjellë aplikimin e masës disiplinore

⁵ Që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka.

ekstreme të shkarkimit nga detyra për të. Bashkëshorti i saj nuk e ka marrë pjesën takuese nga vlera e përfituar prej shitjes së sipërfaqes 6.000 m², prandaj edhe nuk e ka deklaruar.

3.5. Për analizën financiare të periudhës 2012-2016, subjekti pretendon se Komisioni nuk e ka pasqyruar atë në vendim. Sipas subjektit, balanca negative për të është në vlerën (-) 1.022.161 lekë, që në bazë të parimit të proporcionalitetit nuk prodhon pasoja që mund të çojnë përpara deklarimit të pamjaftueshëm, për të aplikuar masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

b) *Në lidhje me vlerësimin e kriterit të figurës*

3.6. Subjekti pretendon se gjetjet e pasqyruara në vendimin e Komisionit nuk janë evidentuar në relacionin e rezultateve të hetimit dhe as në seancën dëgjimore. Raporti i DSIK-së nuk përmban të dhëna të besueshme, prova apo fakte konkrete, por konstatime të përgjithshme, subjektive, pa përcaktuar veprimet e paligjshme. Ndërkohë, nuk përmendet asnjë kontakt i papërshtatshëm për të.

3.7. Është cenuar procesi i rregullt ligjor, pasi nuk është njohur me informacionet e klasifikuara në mënyrë të padrejtë nga Komisioni si “sekret shtetëror”.

3.8. Për çështjen konkrete që i kaloi barra e provës, subjekti pretendon se ka dhënë shpjegime, duke analizuar përmbajtjen dhe themelin e vendimit të saj, ndërsa Komisioni ka tejkuluar kompetencat kushtetuese e ligjore të organeve të rivlerësimit duke ia nënshtruar hetimit. Sipas subjektit, kjo përbën një arsye më shumë për të kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Qëndrimi subjektiv i Komisionit shfaqet edhe në analizën e vlerësimit të aftësive profesionale, pasi në vendim Komisioni nuk ka evidentuar konkluzionet e grupit të punës së KLGj-së.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) *Juridiksioni i Kolegjit*

4. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, për rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim që ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankueses*

5. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma e shqyrtimit të ankimit në Kolegj*

6. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimeve nga subjektet e rivlerësimit i nënshtrohet parashikimit të nenit 49⁶ të ligjit nr. 49/2012, dhe si rregull shqyrtohet në bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit.

6.1. Një nga kërkesat e subjektit të rivlerësimit, në ankim, ishte kalimi për shqyrtim i çështjes në seancë gjyqësore publike dhe riçelja e hetimit gjyqësor. Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka përcjellë disa akte⁷ dhe kërkuar që të pranohen në Kolegj, për shkak se situata faktike është konstatuar gabim nga Komisioni. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në kushtet që subjekti i rivlerësimit nuk ka parashtruar rrethana që kanë penguar paraqitjen e këtyre provave gjatë hetimit në Komision dhe dokumentet nuk përbëjnë fakte të reja, të panjohura më parë, gjejnë zbatim kriteret ndaluese për provat e reja me ankimin, nën dritën e nenit 47⁸ të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Pavarësisht nga ky konstatim, edhe nga përmbajtja e dokumentacionit, rezulton se nëpërmjet akteve të sjella bashkë me ankimin nuk derivohen fakte të cilat do të kishin ndikim në vendimmarrje, pasi të njëjtat rrethana, subjekti i ka potencuar gjerësisht edhe gjatë hetimit administrativ në Komision – kryesisht faktin e mungesës së dokumentacionit provues për të ardhurat e përfituara nga prindërit gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar.

6.2. Si rrjedhojë, nën dritën e nenit 49, pika 6, shkronjat “a”, “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, këto akte nuk u pranuan në cilësinë e provës e as mund të krijonin nevojën për të shqyrtuar ankimin në seancë publike në prani të subjektit, për të konstatuar saktësisht gjendjen faktike, sipas nenit 51 të ligjit nr. 49/2012. Trupi gjykues i Kolegjit nënvizon që pretendimet për këtë zë të ardhurash arsyetohen gjerësisht në vijim, në kontekstin e shkakut të ankimit përkatës dhe efektit mbi vlerësimin e pasurisë. Në këtë pjesë të vendimit, për efekt të qartësisë në arsyetimin e trupit gjykues, shtjellohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet e subjektit për secilin akt dhe vlerësimi për to.

6.3. Për të provuar që prindërit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga aktiviteti i tyre tregtar, për të kontribuar në favor të saj me shumën 56.000 USD, subjekti ka paraqitur si provë të re një kartelë depozite *kursimi* në (ish) Bankën e Kursimeve Fier. Nga ky akt rezulton se babai i saj ka pasur të depozituar 2.000.000 lekë në bankë në vitin 2001. Kjo vlerë, shpjegon subjekti, është tërhequr për të përballuar jetesën në Tiranë. Subjekti shprehet se nuk e ka paraqitur këtë akt në Komision, pasi iu duk e panevojshme dhe që kishte përmbushur barrën e provës nëpërmjet akteve të tjera të dorëzuara. Subjekti potencon se shkresa e bankës, shoqëruar me deklaratën e punonjësit të Bashkisë, vërteton ushtrimin e aktivitetit të shitjes ambulante të prindërve dhe ligjshmërinë e burimit të të ardhurave në shumën prej 56.000 USD të krijuara në vitin 2003.

⁶ Gjykimi në apel administrativ në dhomë këshillimi.

⁷ Konkretisht, me ankimin subjekti ka sjellë: (1) shkresë nga e Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Fier [nr. {***} prot.], datë 07.07.2020; (2) shkresë nga Drejtoria e Arkivave Shtetërore Vendore [nr. {***} prot.], datë 19.07.2021; (3) kartelë depozite *kursimi* në emër të babait të subjektit nga Dega e Bankës së Kursimeve Fier dhe certifikata e lindjes; si dhe (4) komente nga rrjeti social lidhur me shkarkimin e saj nga detyra prej Komisionit.

⁸ “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj. [...]”.

6.4. Subjekti pretendon se *gjendet në kushtet e pamundësisë së gjetjes së dokumentacionit të shlyerjes së detyrimeve tatimore për aktivitetin tregtar të prindërve*. Ajo argumenton se duke mos pasur detyrim deklarimi, prindërit duhet të analizohen në kontekstin e ligjit të kohës kur është kryer aktiviteti i shitjes ambulante, në dritën e parimit të proporcionalitetit. Janë këshillat e komunave dhe bashkive institucionet që vendosin për zbatimin e taksës apo tarifës vendore dhe ligji nuk parashikonte detyrimin e tregtarëve ambulantë për regjistrim dhe deklarim të të ardhurave të përfituara në organet tatimore të bashkisë/komunës. Vetëm me ligjin e vitit 2006 u vendos që ambulantët duhet të pajiseshin me NIPT, të regjistroheshin, të paguanin taksë vendore dhe të paguanin kontributet për sigurimet. Para këtyre ndryshimeve, shitësve ambulantë iu kërkohej vetëm taksa ditore e zënies së hapësirës publike për aktivitet. Subjekti ka paraqitur një shkresë të datës 19.07.2021, të Drejtorisë së Arkivave Shtetërore Vendore, e cila referon se nuk ka të regjistruar dokumentacion të Ndërmarrjes së Tregut të Lirë në Fier. Sipas subjektit, është përmbushur përcaktimi i pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasi ajo dhe personat e lidhur ndodhen në kushtet e pamundësisë së paraqitjes së dokumentacionit, për sa kohë Bashkia Fier nuk ka mbajtur një regjistër ku të dokumentohen taksat.

6.5. Duke vënë në theks natyrën deklarative të argumenteve të subjektit, për arsyen e mosparaqitjes së këtyre akteve gjatë hetimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se gjithsesi, për nga përmbajtja, ato nuk përfaqësojnë risi kundrejt sa subjekti ka pretenduar gjatë hetimit administrativ. E thënë ndryshe, edhe duke abstraguar nga ndalimi që përcakton neni 47 i ligjit nr. 49/2012, për provat e reja me ankimin, këto akte nuk potencojnë ngjarje apo rrethana që subjekti nuk i ka pretenduar gjatë hetimit administrativ – konkretisht, mundësinë e prindërve për t'i dhënë asaj dhe bashkëshortit shumën 36.000 euro apo pamundësinë objektive të saj për të provuar shlyerjen e detyrimeve tatimore nga aktiviteti i tyre si tregtarë ambulantë. Së fundmi, këto akte, edhe nëse do të ishin pranuar, nuk arrijnë të ndryshojnë zgjidhjen e çështjes, sikurse arsyetohet në vijim dhe në vlerësimin e themelit të shkaqeve të ankimit. Për rrjedhojë, ato nuk u pranuan nga trupi gjykues i Kolegjit nën dritën e përcaktimit të germave “a”, “b” dhe “d” të pikës 6 të nenit 49⁹ të ligjit nr. 84/2016.

6.6. *Së pari*, shkresa e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Fier, duke abstraguar që është hartuar pasi subjekti u njoh me vendimin e Komisionit¹⁰, ka në thelb të njëjtën përmbajtje me shkresa të depozituara dhe analizuara nga Komisioni bashkë me rezultatet e hetimit administrativ¹¹, lëshuar nga administrata tatimore sikurse edhe nga e njëjta zyrë¹². Këto shkresa konfirmojnë pretendimet e subjektit e, konkretisht, se tregtarët ambulantë nuk kishin detyrim të regjistroheshin në bashki. E vetmja risi që përbën shkresa e paraqitur në ankim është detaji që lidhet me djegien e arkivës së Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Fier, për vitet 1993-1997. Sikurse arsyetohet në vijim, trupi gjykues vëren se, gjithsesi, përmbajtja e kësaj shkrese lë të pashpjeguar mungesën e akteve për aktivitetin e ushtruar në pjesën e mbetur të kohës, në vitet 1998-2001.

⁹ “6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit”.

¹⁰ Shkresa mban datën 07.07.2020, ndërsa referohet si përgjigje e kërkesës së subjektit të datës 22.06.2021; për pasojë, u prezumua gabim shifre e vitit e, si rrjedhojë, duhet të jetë shkresë e datës 07.07.2021.

¹¹ Shkresë nr. {***} prot., datë 11.12.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

¹² Shkresë nr. {***} prot., datë 22.04.2021.

6.7. Në kushtet që djegia e akteve të disponuara nga arkiva deri në vitin 1997 është referuar për herë të parë vetëm me ankimin, kjo shkresë paraqet problematika besueshmërie për shkak të mospërputhjes me aktet e mëparshme apo edhe nën dritën e kuadrit ligjor që normonte aktivitetin tregtar të vogël në vitet në fjalë, analizuar në vijim. Për rrjedhojë, ajo vlerësohet se bie ndesh me kërkesat e pikës 4 të nenit 49¹³ të ligjit nr. 84/2016, në drejtim të pretendimit të subjektit për pamundësi objektive¹⁴ për të provuar të ardhurat e prindërve, në funksion të huadhënies, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. *Së fundmi*, sikurse ka konstatuar edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vëren se shkresa e depozituar me ankimin nuk provon as në aspektin *sasior* të ardhurat e krijuara nga ky aktivitet apo një nivel të atillë që ishte i mjaftueshëm edhe për të shërbyer për të kontribuar me hua në një vlerë të konsiderueshme në vitin 2016.

6.8. Edhe kartela e *depozitës* së kursimit, në emër të babait të subjektit, lëshuar nga Dega e (ish) Bankës së Kursimeve Fier, që mban datën 30.04.2001, po ashtu e sjellë për herë të parë me ankimin, do të ishte gjithsesi pa ndikim në zgjidhjen e çështjes, pasi vlerësohet se nuk përmbush kërkesën e pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për shkak problematikash të aspekteve të ndryshme. Sipas këtij dokumenti, babai i subjektit ka kryer veprime depozitimesh dhe tërheqjesh në vlera të ndryshme gjatë vitit 2001, në një depozitë kursimi. Sikurse arsyetohet në vijim, subjekti argumenton se vlerat e referuara në shkresë, që në mars 2001 arrijnë në 2.000.000 lekë, ishin rrjedhë e aktivitetit të shitjes ambulante të prindërve.

6.9. Për nga forma, rezulton se shkresa është një fotokopje e thjeshtë e panjësuar me origjinalin. Për nga përmbajtja, në të nuk ka përshkrime apo specifikime nga të cilët të mund të krijoheshin indicie për burimet e krijimit të fondeve. Në vitet 2001-2002, prindërit e subjektit kanë pasur edhe veprime të tjera financiare, përfshirë shitjen e apartamentit në Fier dhe blerjen e një apartamenti në Tiranë. Veprimet financiare me peshë, referuar këtij akti, ndodhin në një hark kohor të afërt me këto transaksione pasurore të prindërve. Në konsideratë të të gjithë këtyre aspekteve dhe, mbi të gjitha, distancën e gjatë kohore të veprimeve që referon kjo shkresë nga huadhënia, në tetor 2016, edhe në këndvështrimin më favorizues për subjektin, ky dokument u vlerësua i pamjaftueshëm për të marrë cilësinë e provës së re në ankim.

6.10. Trupi gjykues i Kolegjit evidenton se Komisioni ka hetuar pranë Raiffeisen Bank (ish-Banka e Kursimeve), ashtu edhe pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe i është vënë në dispozicion informacioni lidhur me depozitën bankare të babait të subjektit në vitet 2003-2004. Ky informacion lidhet drejtpërdrejtë me pretendimet e subjektit të ngritura si në Komision, ashtu edhe në ankim për burimin e të ardhurave. Nga hetimi i kryer nga Komisioni në Raiffeisen Bank, nuk është përcjellë kartela e depozitës së vitit 2001 bashkëlidhur ankimit.

6.11. Në të njëjtën mënyrë, trupi gjykues analizoi edhe shkresën e Drejtorisë së Arkivave Shtetërore Vendore të lëshuar në datën 19.07.2021. Sipas kësaj shkrese, *nuk disponohet dokumentacion për llojin e taksës dhe nivelin e tyre*, si dhe që ky institucion *nuk ka të regjistruar dokumentacion nga Ndërmarrja e Tregut të Lirë Fier*. Subjekti nuk ka paraqitur

¹³ “[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelit të bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”.

¹⁴ “[2.] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor. [...]”.

argumente/shkaqe që të provojë, përse nuk ka mundur ta paraqesë ose ta kërkojë të administrohet si provë në Komision kjo shkresë, në respektim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Nga ana tjetër, rezulton se Komisioni administroi një shkresë të Bashkisë Fier që përmban të njëjtin informacion sikurse edhe shkresa e dërguar nga subjekti në ankim, në korrespondencën e zhvilluar në prill 2021¹⁵. Të gjitha këto akte, në pikën fundore, nuk provojnë krijim të ardhurash nga prindërit e subjektit, qoftë edhe vetëm në këndvështrimin sasior, duke abstraguuar nga pyetje të vëllimit të aktivitetit. Si konkluzion, edhe kjo shkresë, përpos që nuk përmbush kriterin e pranimit të provës së re në ankim, është e pamjaftueshme të passjellë ndikim në zgjidhjen e çështjes.

6.12. Në *parashtrimet* e datës 26.09.2024, përpara seancës gjyqësore në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar pretendimet në ankim, si dhe ka sjellë edhe tre akte të reja: (i) një vendim gjykate për zgjidhjen e martesës për të dhe bashkëshortin, që mban datën 18.04.2024; (ii) një nxjerrje llogarie me transaksione të kryera nga nëna e saj në vitin 2005, në funksion të një huadhënieje në vlerën 12.000 euro; dhe (iii) një deklaratë noteriale të të atit, që mban datën 26.01.2024 dhe një nxjerrje llogarie të saj, me të cilat ajo provon shlyerjen e huas së marrë nga i ati.

6.13. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi i analizoi këto akte, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim kundrejt pretendimeve të subjektit, konstatoi se asnjë prej tyre nuk përmban të dhëna të cilat kanë peshë në zgjidhjen e çështjes dhe, si të tilla, i vlerësoi të panevojshme nën dritën e pikës 6 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016. Konkretisht:

6.13.i. Veprimet financiare të kryera nga nëna e subjektit në vitin 2005-2006, sipas saj, provojnë mundësinë financiare të prindërve për t'i dhënë huan 36.000 euro. Nga nxjerrja e llogarisë në Tirana Bank, subjekti pretendon se nëna i ka dhënë motrës së saj [tezes së subjektit] hua një vlerë 12.000 euro në vitin 2005, dhe se këtë hua ia ktheu në llogari në vitin 2006. Edhe duke abstraguuar nga fakti që datojnë përpara vendimit të Komisionit e duhet të ishin përcjellë gjatë hetimit administrativ, këto veprime, gjithsesi, provojnë një sasi të ardhurash në një llogari bankare të nënës, për të cilat nuk ka asnjë të dhënë për burimin e krijimit e prejardhjen e tyre. Po ashtu, sikurse arsyetuar për një akt tjetër më sipër, harku kohor mes veprimeve bankare dhe huadhënies, gjatë të cilit nuk ka gjurmë me akte të kohës, e bën të pamundur konfirmimin që flitet për të njëjtat të ardhura, të cilat janë mbajtur nga prindërit e subjektit të ngurtësuar në *cash*, jashtë sistemit bankar, për 10 vite.

6.13.ii. Nëpërmjet vendimit të gjykatës që ka zgjidhur martesën e saj¹⁶, subjekti pretendon se i është cenuar jeta private e mbrojtur nga neni 8 i KEDNj-së. Sipas subjektit, pasi është shkarkuar nga detyra, bashkëshorti vendosi të finalizonte zgjidhjen e martesës, pasi të ardhurat e saj u pakësuan. Kërkesa për zgjidhjen e martesës në datën 19.01.2024 dhe vendimi përkatës i gjykatës datojnë pasi subjekti ka paraqitur ankimin objekt shqyrtimi. E thënë ndryshe, ky kërkim parashtron një pasojë që ka ndodhur përtej sferës së shkaqeve të ankimit, të cilat kanë për fokus kriteret e rivlerësimit kalimtar.

6.13.iii. Duke mbajtur në konsideratë elementet tërësisht deklarativë që paraqet ky pretendim – e konkretisht, efektin negativ që ka pasur masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në jetën

¹⁵ Shkresë e Komisionit më 16.04.2021 dhe kthim përgjigjeje nga Bashkia Fier, me nr. {***} prot., datë 22.04.2021, sipas së cilës “tregtarët ambulante kanë paguar biletë ditore për zënie të vendit ku ushtrojnë aktivitet” dhe që Bashkia Fier “nuk ka arkivë dhe nuk ka një regjistër ku të dokumentohen pagesat e taksave në vitet 1993- 2001”.

¹⁶ Vendim nr. {***}, datë 18.04.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

personale të subjektit -- trupi gjykues i Kolegjit vëren se është e pamundur të provohet në një proces gjyqësor, përfshirë edhe atë të rivlerësimit, shkaqet që kanë afektuar një marrëdhënie si ajo martesore, sikurse edhe teorikisht e pamundur t'i atribuohet ajo një shkaku të vetëm. Edhe mospërputhja në vetvete e vendimit gjyqësor për zgjidhjen e martesës¹⁷ duhet të prezumohet se ka qenë pasqyrim në tërësi i pretendimeve të kërkuases/subjektit për zgjidhjen e martesës, më tepër sesa ajo që rezulton nga leximi literal i vendimit që në pamje të parë në thelb, jo vetëm që parashtron një sërë pretendimesh të subjektit në procesin e rivlerësimit¹⁸, përpjekje e gjykatës për të identifikuar ekzaktësisht arsyen për të cilën palët kanë vendosur të zgjidhin një raport me natyrë tërësisht subjektiv/emocionale. Si rrjedhojë, analizuar edhe nën kontekstin e proporcionalitetit që kërkon neni 8 i Konventës Evropiane, ky pretendim u pa nga trupi gjykues i pamundur objektivisht për t'ia atribuuar e ndikuar mbi zgjidhjen e çështjes.

6.13.iv. Në këtë linjë, trupi gjykues vëren se në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, GjEDNj-ja ka vlerësuar se shkarkimi i subjektit nga detyra e gjyqtares nuk erdhi si pasojë e kontrollit të jetës private dhe shkarkimi nga detyra dhe humbja e pagës së gjyqtares, pavarësisht efektit financiar për *rrethin e saj të ngushtë*, nuk ka passjellë mohimin e të drejtës për të ushtruar profesionin e juristes. Për më tepër, shkarkimi nga detyra subjektit i erdhi për faktin se ajo nuk arriti që të justifikojë bindshëm e me dokumentacion mundësinë e krijimit të pasurive të cilat ajo i ka gëzuar me familjen/bashkëshortin. Subjekti është shkarkuar për çështje që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe për disa aspekte të kontrollit të figurës.

6.13.v. *Së fundmi*, me parashtrimet, subjekti ka sjellë edhe akte për të provuar vërtetësinë e marrëdhënies së huas me të atin dhe kthimin e saj brenda harkut kohor 2020-2023. Duke abstraguar nga momenti kur këto shkresat u paraqitën, trupi gjykues vëren se gjithsesi përmbajtja e tyre nuk arrin të provojë lidhjen midis të ardhurave të babait të subjektit të depozituara në bankë në vitin 2003 dhe aktivitetit të shitjes ambulante përgjatë periudhës 1993 – 2001. Si të tilla, këto dokumente nuk iu nënshtuan hetimit dhe nuk morën cilësinë e provës së re.

6.14. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se aktet e sjella në ankim dhe parashtrime, përpos mospërmbushjes së kriterëve për ndalimin e përcaktuar nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012, për aktet e reja në ankim, nga një analizë e vlerës provuese të tyre, në kuptim të neneve 45 e 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, u vlerësuan pa peshë për të ndikuar e ndryshuar mbi zgjidhjen e çështjes apo mbi formën e gjykimit. Për rrjedhojë, nuk janë përmbushur kriteret e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, pasi situata nga Komisioni është konstatuar drejt, nuk ishte e nevojshme të merren prova të reja, si dhe nuk u konstatuan shkelje të rënda procedurale për t'u shëruar nga

¹⁷ Konkretisht, ndërsa në pikën 4 në të njëjtën linjë si subjekti në parashtrime, vendimi i gjykatës referon që “ekuilibrat e familjes u prishën dhe bashkëshorti krijoi edhe një marrëdhënie të re”, si pasojë e shkarkimit të saj nga detyra, në pikën 3 pasqyrohet një situatë që paraqitet më tepër si riprodhim i pretendimit të palëve, dhe si marrëdhënie e konsoliduar, prej vitit 2010 – 2024, “e mbështetur në bashkëpunimin reciprok, harmoni, familje të bukur e të shëndetshme, komunikim, ndjenjë dashurie dhe respekti kundrejt njëri-tjetrit”.

¹⁸ Ndër të tjera, në rubrikën “Rrethanat e çështjes”, ku gjykata/gjyqtari i vetëm pasqyron të dhëna që sjellin në pah detaje lidhja e të cilave me kërkesëpadinë është e vështirë të krijohet, siç janë shpjegimet tejet të detajuara për natyrën tejet të konsoliduar të martesës që ka gëzuar subjekti e bashkëshorti përpara se të shkarkohej nga detyra me vendimin objekt ankimi të Komisionit, në paragrafin nr. 3, apo detaje ekzakte të kohëzgjatjes së banimit të subjektit [dhe bashkëshortit të saj] me prindërit “ndërsa pas blerjes së apartamentit në bashkëpronësi të tyre, në datën 24.08.2016, rreth muajit shtator kanë filluar jetesën e përbashkët në këtë apartament, adresa [...] Kompleksi i banimit “{***}”, [...] Tiranë”, që duken jashtë sferës së kërkesëpadisë për zgjidhjen e martesës me mirëkuptim të bashkëshortëve Dardha-A., si dhe faktit që pronësia e përdorimi i apartamentit nga subjekti pas zgjidhjes së martesës nuk ka qenë objekt kontestimi nga ish-bashkëshortët në atë proces.

Kolegji. Në analizë të sa më sipër, sipas nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, shqyrtimi i kësaj çështjeje u zhvillua në dhomë këshillimi pa praninë e palëve.

B. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me procesin e rregullt ligjor

7. Subjekti pretendon se në rastin se saj, Komisioni nuk ka respektuar parimin e ligjshmërisë, në drejtim të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, e drejtësisë dhe paanësisë, i barazisë para ligjit, i proporcionalitetit, objektivitetit, për një proces të rregullt ligjor nëpërmjet kontradiktorialitetit e të barazisë së armëve. Po ashtu, sipas subjektit, Komisioni nuk ka gjykuar provat dhe faktet në mënyrë të paanshme. Për këto shkaqe, sipas subjektit, Komisioni ka mbërritur në një përfundim të gabuar të pasurisë dhe të figurës, përmbyllur me konkluzionin për *cenim të besimit* të publikut te drejtësia.

7.1. Nga analiza e pretendimeve për këtë aspekt të ankimit, nën dritën e dispozitave kushtetuese, ligjore e konventore që gjejnë zbatim, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit janë të pabazuara. *Së pari*, trupi gjykues vëren se këto pretendime janë të përgjithshme, pasi nuk identifikojnë rrethana apo veprime specifike të Komisionit, që janë shkas për këtë pretendim. Nga ana tjetër, nga kontrolli i kryer në Kolegj në nivel parimor, rezulton se hetimi administrativ i kryer nga Komisioni ka qenë në respektim të garancive për proces të rregullt. Komisioni ka vendosur komunikim të rregullt me subjektin dhe i ka dhënë mundësinë të sjellë akte për të provuar pretendimet dhe për të shpjeguar faktet për të cilat është pyetur. Në datën 14.05.2021, subjekti është njohur me gjithë fashikullin e krijuar gjatë hetimit administrativ, qoftë për vlerësimin e pasurisë apo të figurës dhe ka marrë nga Komisioni të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej saj në formë CD-je dhe/ose shkresore¹⁹. Subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë vërejtje me materialet që tërhoqi nga Komisioni dhe se dokumentacioni përputhet me atë në dosje. Momenti kohor në fjalë, daton pasi Komisioni ka administruar raportin e rishikuar, dërguar me shkresën e DSIK-së, në datën 09.04.2021, nëpërmjet të cilit ndryshoi vlerësimi për figurën e subjektit nga *përshtatshmëri* në *papërshtatshmëri*. Ky dokument është klasifikuar “sekret”.

7.2. Këto aspekte paraqesin rëndësi nën dritën e pretendimit të subjektit për moskalim të barrës së provës për të dhënat që kanë rezultuar nga informacionet e organeve ndihmës për konkluzionet e figurës, porë në kontekstin e të drejtave procedurale për proces kontradiktor dhe për barazinë e armëve, ngritur nga subjekti me pretendimin për mosnjohje me provat mbi të cilat janë mbështetur raportet e klasifikuara të organeve ndihmëse [raporti i DSIK-së]. Edhe për këtë aspekt, rezulton se pretendimi i subjektit është i pambështetur në situatën faktike. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për informacionet që ngrinin dyshime për veprime korruptive në një çështje të shqyrtuar prej saj, përfunduar me vendim në vitin 2019. Në rezultatet e hetimit, Komisioni ka informuar subjektin se ka bërë hetime të mëtejshme duke kërkuar dosjet përkatëse, bazuar në raportin e DSIK-së dhe i ka kaluar asaj barrën e provës për këtë dosje. Subjekti ka dhënë sqarime të detajuara rreth vendimmarrjes së saj, konkretisht në faqet 22-26 të prapësimeve të rezultateve të hetimit dhe Komisioni i ka marrë ato në shqyrtim e analizuar në paragrafët 140-142.3, në faqet 20-24 të vendimit objekt analize. Për më tepër, gjatë hetimit në Komision, subjekti nuk ka ngritur asnjë pretendim të kësaj natyre. Për rrjedhojë, ky pretendim është i pabazuar. Rezulton e provuar që subjekti e ka ushtruar të drejtën për t’u njohur me dosjen, për të dhënë sqarime e për të paraqitur

¹⁹ Sipas shkresës së nënshkruar, pjesë e fashikullit të Komisionit në faqen 1627.

prova, të drejta të cilat subjekti i ka ushtruar. Komisioni ia ka garantuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, duke ia nënshtruar provat debatit edhe në seancën dëgjimore. Në mënyrë më të detajuar, pretendimet që lidhën me aspektin e kontrollit të figurës janë trajtuar në vlerësimin e këtij kriteri.

7.3. Bazuar në analizën financiare të hartuar nga anëtari në pakicë i trupit gjykues të Komisionit, për periudhën 2012 – 2016, subjekti pretendon se balanca negative që rezulton pas kontrollit të pasurisë së saj [në vlerën (-) 1.022.161 lekë, sipas komisionerit Komici²⁰] është e pamjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra, me pasojë aplikimin e zbatimit të parimit të *proporcionalitetit*.

7.4. Ndërsa themeli i analizës së shkaqeve të ankimit gjen trajtim të zgjeruar në vijim, në këtë pikë, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që Komisioni ka marrë masën e shkarkimit nga detyra, pasi ka konstatuar mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe deklarim të pasaktë, referuar germave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të dy pasurive, si dhe cenimit të besimit të publikut, sipas pikës 5 të nenit 61 të po këtij ligji. Pavarësisht nëse konkluzioni i Komisioni ka qenë i saktë, në kushtet që shumica ka konstatuar ndryshe nga komisioneri në pakicë, duke e përlllogaritur balancën negative të burimeve të ligjshme më së paku të njëjtë me huan prej 36.000 eurosh, proporcionaliteti i pretenduar nga subjekti, duke kërkuar mosaplikimin e masës disiplinore, është i pabazuar. Me fjalë të tjera, kërkesa e subjektit do të bënte kuptim nëse balanca negative e shumicës është e njëjtë me atë të komisionerit në pakicë. Për sa kohë shumica e trupit gjykues ka vlerësuar se mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë dhe problematikat e tjera janë përtej kufirit financiar të pranuar në drejtim të zbatimit të një vendimi proporcional dhe shumë e ndryshme nga ajo e përlllogaritur sipas një vlerësimi ligjor të komisionerit në pakicë, pretendimet e subjektit janë të pakuptimta.

7.5. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar edhe pretendimin e subjektit për cenim të barazisë përpara ligjit dhe dyshime serioze për qëndrim paragjykes, meqenëse dy komisioneret që kanë marrë vendimin e shumicës në Komision kanë vlerësuar ndryshe në një çështje tjetër²¹. Duke abstraguuar nga fakti që ky pretendim për trajtim pabarabartë të shumicës së Komisionit me subjektin tjetër është ngritur për herë të parë në ankim, shqyrtimi i këtij ankimi, passjell edhe njësimin e qasjeve të Komisionit nëpërmjet juridiksionit kontrollues të Kolegjit²². Në këto kushte, shqyrtimi i ankimit adreson rëndësinë e nënvizuar nga GjEDNj-ja për krijimin e mekanizmave që mund të sigurojnë koherencën e praktikës dhe njësimin e jurisprudencës²³. Vlerësimi i subjekteve të rivlerësimit që kanë kryer të njëjtat shkelje, në kontekstin e parimit të barazisë para ligjit, duhet të mbështetet në specifikat dhe rrethanat konkrete. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit mban në konsideratë qëndrimin e shprehur nga Gjykata Kushtetuese, si dhe GjEDNj-ja për interpretimin e barazisë para ligjit në praktikë, duke elaboruar se nëse nuk ka objektiv dhe arsye të përligjor, me fjalë të tjera, nëse nuk ndjek një synim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjetit të përdorur dhe synimit të kërkuar për t’u përmbushur, Gjykata e ka vlerësuar trajtimin e diferencuar si diskriminues²⁴.

²⁰ Faqet 8 dhe 12 të mendimit të pakicës.

²¹ Vendimi i Komisionit nr. 342, datë 02.02.2021, për subjektin e rivlerësimit, znj. Elbana Lluri.

²² Referuar nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

²³ *Shih Beian v. Romania (no. 1)*, §§ 37 dhe 39; *Lupeni Greek Catholic Parish and Others v. Romania [GC]*, §§ 116-35).

²⁴ *Burden k. Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 60 ose vendimi nr. 71/1998 i Gjykatës Kushtetuese.

7.6. Në kushtet që pretendimi në fjalë nuk ilustron rrethana konkrete, të cilat kanë përbërë veprime paragjyquese e mungesë trajtimi të barabartë, përpos krahasimit me një subjekt tjetër, trupi gjykues i Kolegjit e analizoi këtë pretendim në nivel teorik. Nga kjo analizë, rezultoi se Komisioni ka ndjekur procedurën standarde të kryerjes së hetimit administrativ, parashikuar nga Hapat Proceduralë të Unifikuar. Anëtarët e trupit gjykues kanë shprehur mospasjen e konfliktit të interesit, ashtu sikurse edhe subjekti është shprehur se nuk kishte dijeni për gjendje të tillë. Subjekti i ka kthyer përgjigje tre pyetësorëve dhe në përfundim të hetimit administrativ i ka kaluar barra e provës me rezultatet e hetimit. Subjekti është njohur me aktet (referuar më sipër po ashtu) dhe ka shtyrë me dy javë afatin e përgjigjeve të rezultateve të hetimit, sipas kërkesës së subjektit. Komisioni ka zhvilluar seancën dëgjimore gjatë së cilës ka dëgjuar dhe analizuar, ndër të tjera, edhe shpjegimet e subjektit. Këto rrethana nuk tregojnë ndonjë element që paraqet situatë njëanshmërie apo paragjykim të trupës gjyquese të Komisionit, ashtu sikurse edhe subjekti nuk ngriti pretendime të tilla gjatë hetimit administrativ.

7.7. *Së fundmi*, edhe pretendimi për probleme mungese *arsyetimi* në vendim, meqenëse sipas subjektit janë pasqyruar pak apo pjesërisht shpjegimet e saj për vlerësimin e pasurisë, u vlerësua i pabazuar dhe i pakuptimtë. Vendimi i Komisionit përmban dhe identifikon lehtësisht të gjitha pjesët e përcaktuara nga neni 57 i ligjit nr. 84/2016²⁵. Pasi ka parashtruar rrethanat e faktit, Komisioni ka analizuar provat, shpjegimet dhe qëndrimet e subjektit për çdo aspekt të pasurisë për të cilin i ka kaluar barrën e provës. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit për secilin aspekt, për të cilin i ka kaluar barra e provës, pasqyrohet gjerësisht në pjesët përkatëse, përfshirë paragrafët 40-47, 78, 96, 116-118 – për kriterin e pasurisë, ndërkohë që ka pjesë ku qëndrimi i saj është referuar bazuar në përgjigjet e pyetësorëve.

7.8. Fakti që Komisioni nuk ka riprodhuar tekstualisht/verbatim shpjegimet e subjektit në çdo pjesë të analizës, edhe nëse ka zgjedhur të shprehet në mënyrë të përmbledhur apo i është referuar pyetësorëve saktësisht, nuk mund të argumentohet si mungesë arsyetimi. Për secilin aspekt të vendimit ka një analizë të dedikuar. Sikurse elaboruar edhe nga GjEDNj-ja në praktikën e saj, gjykata nuk ka nevojë që t'i përgjigjet në mënyrë të detajuar çdo pretendim të subjektit/ankuesit. Ajo duhet të kthejë përgjigje për faktet dhe rrethanat që janë relevante për zgjidhjen e çështjes, e që i japin ankueses argumente të mjaftueshme për të ngritur një ankim²⁶. Kjo qasje është konfirmuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, sipas së cilës, vendimi duhet të përmbushë jo vetëm elementët formalë, po edhe ato substancialë, duke i dhënë përgjigje çështjeve të ngritura, marrë në analizë provat dhe faktet, e të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm. Arsyetimi duhet të tregojë arsyet mbi të cilat mbështetet vendimi²⁷.

²⁵ Neni 57 i ligjit nr. 84/2016, për vendimin e Komisionit përcakton si vijon: “[2.] Vendimi përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese. 3. Hyrja e vendimit përmban: a) emërtimin zyrtar të Komisionit; b) trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen dhe punonjësën administrativ; c) orën dhe vendin e vendimit të dhënë; ç) emrin dhe identitetin e subjektit të rivlerësimit, si dhe përfaqësuesve të tij; d) mendimin e subjektit të rivlerësimit dhe/ose të përfaqësuesit të tij. 4. Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet; 29 c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi. 5. Pjesa urdhëruese, ndërmjet të tjerash, përmban: a) alternativën që ka vendosur trupi gjykues; b) nëse trupi gjykues ka vendosur të caktojë një masë disiplinore; c) të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij”.

²⁶H. Kundër Belgjikës <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-57501%22%7D>; Suominen kundër Finlandës, § 36 <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-61178%22%7D>; Hirvisaari kundër Finlandës, § 30 <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-59682%22%7D>, si dhe: Van de Hurk kundër Hollandës, § 61; García Ruíz kundër Spanjës [GC], § 26; Jahnke and Lenoble kundër Francës (déc.); Perez kundër Francës [GC], § 81.

²⁷ Shih vendimet nr. 3, datë 19.02.2013 dhe nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese.

7.9. Nga vendimi prej 28 faqesh i Komisionit, pjesa e vlerësimit të pasurisë shtjellohet deri në faqen 18. Ndër to, faqet 7-10, 11-13 dhe 13-18 janë kryesisht analizë e Komisionit me ndërthurje të pretendimeve të subjektit. *Së fundmi* dhe ç'është më e rëndësishmja, në kushtet që ankimi e parashtrimet e subjektit së bashku arrijnë në 113 faqe në total, pa përfshirë aktet bashkëlidhur, është e pamundur të argumentohet cenim i ndonjë të drejte të subjektit për shkak të mënyrës sesi shumica e Komisionit ka zgjedhur të shprehet, qoftë nën dritën e vetëm kësaj të dhëne numerike apo edhe duke mbajtur në konsideratë që ky pretendim ka gjetur vetëm argumentim teorik, pa u materializuar në pamundësim të subjektit për të ushtruar ankimin në praktikë.

7.10. Për sa më lart, pretendimet e subjektit, që lidhen me aspekte të respektimit të të drejtave procedurale dhe cenim të procesit të rregullt ligjor në tërësi, nuk qëndrojnë. Nga procesi i ndjekur në Komision, nuk u konstatua asnjë nga *shkeljet* e rënda procedurale që pretendon subjekti. Për rrjedhojë, trupi gjyqësor i Kolegjit vlerëson se këto pretendime kanë për shkas në thelb themelin e zgjidhjes së çështjes nga shumica e Komisionit.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me themelin e çështjes

C/1. *Analiza e shkaqeve të ankimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

I. *Apartament banimi me sipërfaqe 80 m², ndodhur në kompleksin {***}, Tiranë*

8. Subjekti e ka deklaruar pasurinë e sipër-referuar në deklaratën *vetting*, në bashkëpronësi me bashkëshortin, në Tiranë, me vlerë 80.000 euro, blerë në vitin 2015. Si burim krijimi janë deklaruar: (i) kredia 7.000.000 lekë; (ii) huaja në shumën 28.000 euro; dhe (iii) paga personale dhe e bashkëshortit për vitin 2016, në shumën 2.000 euro. Në seksionin e detyrimeve, subjekti ka deklaruar detyrimin sipas kontratës së huas në masën 28.000 euro, ndërsa në seksionin e të dhënave konfidenciale, për këtë kontratë, ka bërë një sqarim nëpërmjet të cilit ka evidentuar se në total ka marrë hua nga prindërit vlerën 36.000 euro dhe vlera 8.000 euro është shlyer me disbursimin e këstit të dytë të kredisë, para nënshkrimit të kontratës së huas.

8.1. Komisioni ka konkluduar se të ardhurat nga aktiviteti tregtar i prindërve nuk provohen me dokumentacion, kanë karakter deklarativ dhe nuk provohet vlera dhe koha e krijimit të tyre. Në përfundim, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm, për shkak se nuk e ka deklaruar vlerën e plotë të huas së marrë, dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, pasi nuk ka dorëzuar dokumentacion ligjor për ligjshmërinë e dy prej burimeve të deklaruara të krijimit të pasurisë e, konkretisht, huas nga prindërit dhe të ardhurat e saj e bashkëshortit nga pagat.

8.2. Subjekti kundërshton të dy këto aspekte të konkluzionit të Komisionit në tërësi. Pa përsëritur sa është referuar më sipër [në paragrafin 3 dhe nënpjesët e tij], subjekti thekson se ka deklaruar vlerën e huas që kishte mbetur e pashlyer në kohën e hartimit të deklaratës *vetting*, në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2016, sikurse edhe referohet në kontratën përkatëse të huas, bashkëlidhur të dy deklaratave [periodike dhe *vetting*]. Diferenca prej 8.000 eurosh është shlyer nëpërmjet disbursimit të pjesës së dytë të kredisë prej 1.200.000 lekësh, tërhequr në tetor të vitit 2016.

8.3. Për sa i përket konkluzionit të Komisionit, për mundësinë e prindërve për krijimin e shumës së dhënë hua me burime të ligjshme, pretendimet e subjektit, përmbledhen në: (i) potencimin e aktivitetit tregtar ambulant prej tyre në vitet 1993-2001, nga i cili kanë gjeneruar

të ardhura të mjaftueshme, dokumentuar nga depozita e babait në vitet 2002-2004 në vlerën 56.000 USD dhe pamundësinë e saj për të sjellë dokumentacion, për shkak se ky aktivitet është rregulluar për herë të parë në vitin 2006. Bashkia Fier nuk disponon dokumentacion dhe, nga ana tjetër, prindërit nuk kanë pasur detyrim ligjor për ta pasur të depozituar këtë shumë në sistemin bankar më herët. Sipas subjektit, ajo është në kushtet e pamundësisë për të provuar burimin e ligjshëm për një pjesë të shumës së marrë hua, prej 2.463.680 lekësh. Subjekti pretendon edhe që: (ii) nga shuma e dhënë hua, 2.500.000 lekë janë nga shitja e apartamenteve nga prindërit. Konkretisht 2.000.000 lekë janë përfituar nga shitja e apartamentit në qytetin e Tiranës, kurse shuma prej 500.000 lekësh e përfituar nga shitja e apartamentit në qytetin e Fierit. Për të dyja këto shuma është paguar detyrimi tatimor, që i bën ato burime të ligjshme për një pjesë të huas, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; dhe (iii) pjesën e mbetur, prej 2.000 eurosh, si edhe në Komision, subjekti ia atribuon të ardhurave nga paga e saj dhe e bashkëshortit.

8.4. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar të plotë vlerën e huas së marrë nga prindërit, ndonëse jo në mënyrë tërësisht të saktë në deklaratën *vetting*. Për pasojë, është *i pabazuar* konkluzioni i Komisionit se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, në kushtet që nga një lexim harmonik i kësaj deklarate, me fokus rubrikën e të dhënave konfidenciale, rezulton e qartë vlera e huas së marrë. Subjekti ka përcaktuar qartë të gjitha të dhënat e pasurisë, vitin e krijimit, vlerën e pasqyruar në dokumentacion, çmimin e blerjes, pjesën takuese dhe burimet e krijimit. Në këto kushte, trupi gjykues e vlerëson të *pabazuar* konkluzionin e Komisionit se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, në kushtet që ndonëse në deklaratën *vetting* mungojnë disa detaje, pasi nga një lexim harmonik i saj, përfshirë edhe sa referohet në pjesën konfidenciale, vlera e huas së marrë nga babai i saj është e qartë dhe lehtësisht e identifikueshme.

8.5. Nga ana tjetër, edhe në analizën e kryer në Kolegji, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për të përballuar plotësisht vlerën e apartamentit. Konkluzioni i Komisionit për mungesë burimesh për krijimin e kësaj pasurie është i bazuar. Pas analizës së kryer në Kolegji për burimet e krijimit të kësaj pasurie, mbi bazën e shkaqeve të ankimit dhe akteve në fashikull, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se personat e *tjerë* të lidhur, prindërit e saj, kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kryer depozitim në *cash* nëpërmjet të cilit është materializuar huaja e vlerës financiare që ka shërbyer për të blerë apartamentin. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit mbi të cilin bazohet konkluzioni i mësipërm shtjellohet në vijim.

8.6. *Së pari*, nga aktet në fashikull rezulton se subjekti e personi i lidhur/bashkëshorti kanë marrë nga babai i subjektit shumën 36.000 euro, në datën 23.06.2016, për blerjen e apartamentit të banimit objekt analize. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar huan nga i ati, në vlerën 28.000 euro, si një ndër burimet e krijimit të pasurisë²⁸. Kontrata e huas, që mban datën 04.01.2017, specifikon edhe që huaja është depozituar *cash* nga huadhënësi në llogarinë e subjektit në Credins Bank. Po aty, palët shprehen se një pjesë e huas, 8.000 euro, ishte shlyer nga huamarrësit me para në dorë, në tetor të vitit 2016, me disbursimin e kështit të dytë të kredisë prej 1.200.000 lekësh. Pjesa e mbetur e huas, në shumën 28.000 euro, do t'i kthehej huadhënësit

²⁸ Kontrata e kalimit të pronësisë së apartamentit rezulton të jetë nënshkruar më datë 24.08.2016, kundrejt çmimit 80.000 euro. Sipas kartelës së pasurisë, prona është regjistruar në emër të subjektit në datën 20.09.2016.

pa afat kohor, në vitet në vazhdim sipas mundësive ekonomike dhe “duke marrë në konsideratë lidhjen familjare” dhe meqenëse subjekti e bashkëshorti kanë burim “vetëm pagat personale”.

8.7. Për kredinë bankare në vlerën 7.000.000 lekë [ekuivalenti i 50.000 eurove], nga Credins Bank, Komisioni nuk ka konstatuar asnjë problematikë. Për rrjedhojë, ky burim krijimi pasurie do të gjejë referencë vetëm për aq sa paraqet relevancë në analizën e krijimit të kësaj pasurie²⁹. Sipas Shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe Udhëzimit nr. 4095/2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, burimi i krijimit të pasurive duhet të identifikohet në *momentin* e krijimit³⁰. Në këtë linjë, në momentin e krijimit të pasurisë objekt analize, në datën 24.08.2016, si burim ka shërbyer huaja në vlerën 36.000 euro e marrë nga prindërit e subjektit, përpos këstit të parë të kredisë. Për rrjedhojë, subjekti do të duhet të kishte deklaruar huan e plotë ndërsa kësti i dytë i kredisë, ka shërbyer për shlyerjen e një pjesë të huas [8.000 euro] dhe jo për shlyerjen e vlerës së apartamentit, i cili tashmë ishte i likuiduar. Për rrjedhojë, qoftë edhe duke ndjekur rrjedhën e thjeshtë kronologjike, subjekti duhet të kishte specifikuar vlerën e mbetur të huas në seksionin e detyrimeve financiare, më 31.12.2016.

8.8. Pavarësisht nga ky konstatim, në kushtet që subjekti e ka deklaruar huan dhe detyrimin e mbetur pa shlyer, në pjesë të ndryshme të deklaratës *vetting* dhe kontrata e huas këto aspekte i identifikon qartësisht, trupi gjykues i Kolegjit çmon se mungesa e koherencës në ndjekjen e gjuhës së ligjit në rrethanat konkrete rezulton pa peshë domethënëse. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit u gjet i bazuar. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar të plotë vlerën e huas së marrë nga prindërit, nëse deklarata *vetting* analizohet në tërësi të saj.

8.9. Duke iu rikthyer huas nga prindërit, analizuar në funksion të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë, referuar kontratës që mban datën 04.01.2017, palët kanë ofruar të dhëna shumë të detajuara për mënyrën e financimit të huas. Në nenin 3 detajohet se është përcaktuar se shuma e dhënë është rezultat i të ardhurave nga: (i) aktiviteti privat në tregun e lirë për periudhën 1993 – 2001; (ii) emigracioni; si dhe (iii) shitja e apartamentit në Tiranë në vitin 2002 dhe apartamentit në Fier në vitin 2001.

8.10. Në analizë të burimeve të mundësisë së personave të tjerë të lidhur për të justifikuar me dokumentacion ligjor të kohës mundësinë e krijimit të vlerës së dhënë hua subjektit, sipas pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit e fokusoi analizën në drejtim të besueshmërisë së ekzistencës së këtyre të ardhurave. Për të ardhurat e prindërve të subjektit, ndër të tjera, trupi gjykues mbajti në konsideratë distancën kohore prej mbi 10 vjetësh mes gjurmëve të fundit dokumentare të këtyre fondeve në dispozicion të personave të tjerë të lidhur, me momentin kur është kryer depozitimi i vlerës së dhënë hua në *cash* në llogarinë e subjektit të rivlerësimit. Në vijim, shtjellohet arsyetimi mbi të cilin u bazua ky konkluzion.

8.11. Për të provuar të ardhurat e prindërve *si shitës ambulantë* në vitet 1993-2001, gjatë hetimit administrativ [në përgjigje të pyetësorit nr. 2], subjekti ka dorëzuar një deklaratë

²⁹ Kontrata e kredisë bankare është nënshkruar më datë 17.06.2016, për vlerën 7.000.000 lekë. Pjesa e parë, 5.800.000 lekë, do të disbursohet pas nënshkrimit [të kontratës së kredisë] dhe pas regjistrimit të pronës në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në emër të subjektit. I njëjti kusht është parashikuar edhe për disbursimin e këstit të dytë prej 1.200.000 lekësh. Nga nxjerrja e llogarisë në Credins Bank, kësti i parë, është disbursuar në datën 23.06.2016, ndërsa kësti i dytë në datën 17.10.2016.

³⁰ Pika 7 e Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016 “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016”.

noteriale të datës 09.12.2020 nga dy individë³¹, të cilët deklarojnë se kanë kryer të njëjtin aktivitet me prindërit e subjektit në periudhën tetor 1993 deri në gusht 2001, në tregun industrial Fier. Po ashtu, deklaruesit shprehen se kanë paguar rregullisht taksat e bashkisë. Në të njëjtin pyetësor, subjekti ka depozituar edhe librezën e punës së babait, çelur nga Drejtoria e Policisë së Qarkut {***} në vitin 2012, nga e cila konfirmohet shkëputja e marrëdhënieve të punës për vitet që përkojnë me aktivitetin tregtar³².

8.12. Nga ana tjetër, në vijim të informacionit të kërkuar nga administrata tatimore, Komisioni është informuar se për periudhën në fjalë tregtarët ambulantë janë administruar nga pushteti vendor³³, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka kthyer përgjigje për dy pyetje të ngritura në një kërkesë për informacion mbi ekzistencën e detyrimeve tatimore për këtë kategori biznesi dhe bazën ligjore përkatëse³⁴. *Së fundmi*, Drejtoria e Taksave dhe Tatimeve të Bashkisë Fier ka informuar Komisionin dhe babanë e subjektit, në dy shkresa të ndryshme, se tregtarët ambulantë *nuk* kanë pasur detyrim të regjistrohen në bashki, por kanë paguar bilete ditore për zënien e vendit ku ushtrojnë aktivitetin. Gjithashtu, ky institucion ka referuar³⁵ se nuk ka arkivë dhe nuk ka një regjistër ku të dokumentohen pagesat e taksave në vitet 1993-2001, për aktivitetin ambulant.

8.13. Në shpjegimet e rezultateve të hetimit, në linjë me shkresat e bashkisë, subjekti ka paraqitur si provë një deklaratë noteriale të datës 24.05.2021, nga një individ që ka shërbyer si ish-inspektor taksash në Bashkinë Fier në periudhën kohore në fjalë dhe konfirmon në linjë me pretendimet e subjektit³⁶ se prindërit e saj kanë punuar në tregun industrial, duke paguar rregullisht taksat dhe detyrimet e bashkisë. Gjithashtu, për të mbështetur pretendimet për të ardhura të gjeneruara nga aktiviteti i prindërve, subjekti ka depozituar në Komision një vërtetim nga një shkollë e mesme jopublike³⁷, që ka ndjekur në vitet 1999-2001, kundrejt një tarife mujore prej 70 USD/muaj ose totalin e 1.260 USD në dy vite. Sipas shpjegimeve të subjektit, në Komision, në kushtet kur prindërit për periudhën 1993-2001 nuk rezulton të ishin të punësuar, por kishin të ardhura për të përballuar jetesën dhe për të shkolluar vajzën në shkollë jopublike, deduktohet se ata gjeneronin të ardhura. Subjekti, po ashtu, ka pretenduar se është në kushtet e *pamundësisë objektive* të paraqitjes së dokumentacionit justifikues ligjor, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Edhe në ankim, sikurse përmbledhur më sipër, subjekti rikonfirmon këto pretendime, duke iu referuar edhe anëtarit në pakicë të trupit gjykues të Komisionit.

8.14. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti e personat e tjerë të lidhur nuk provuan të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i shitjes ambulante në tregun industrial të qytetit të Fierit, me asnjë gjurmë dokumentare të kohës. Deklaratat noteriale të

³¹ Përkatësisht, z. N. T. dhe z. M. K..

³² Sipas përmbajtjes së saj, babai i subjektit nga viti 1981 – 1993 ka qenë i punësuar në Degën e Punëve të Brendshme {***} dhe në Drejtorinë e Policisë së Qarkut {***} për periudhën 2002 – 2012.

³³ Shkresë nr. {***} prot., datë 30.04.2021, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, sipas së cilës për prindërit e subjektit “nuk rezultojnë të dhëna lidhur me regjistrimin si aktivitet tregtar për periudhën 1993-2001. Ambulantët janë pjesë e veprimtarisë së Drejtorive Rajonale Tatimore që nga viti 2003, për periudhën e pretenduar kjo kategori biznesi është administruar nga pushteti vendor”.

³⁴ Shkresë e Komisionit me nr. {***}, datë 16.04.2021, drejtuar DPT-së.

³⁵ Me shkresën e nr. {***} prot., datë 22.04.2021. Shkresa dërguar babait të subjektit mban datën 11.12.2020.

³⁶ Deklarata noteriale e z. M. D. dhe vërtetimin të datës 24.05.2021 nga Bashkia Fier/Drejtoria e Burimeve e Shërbimeve Njerëzore, që konfirmon se deklaruesi, z. M. D., ka qenë punonjës i Bashkisë në pozicionin inspektor i tregut të lirë nga viti 1992 deri në vitin 2002.

³⁷ Vërtetimi nga “{***}” në qytetin e Fierit.

paraqitura nga subjekti, në kuadër të procesit të rivlerësimit, kanë vlerë provuese të kufizuar. Në këto kushte, përjashtohet edhe teorikisht mundësia për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave që mund të jenë gjeneruar nga ky aktivitet, nën dritën e përcaktimit të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Aktet e sjella nga subjekti nuk arritën të provojnë pamundësinë objektive të saj për të dokumentuar këto të ardhura. Sikurse arsyetuar në hyrje të këtij vendimi, edhe nëse do të pranohej shkresa e Drejtorisë së Taksave e Tarifave Vendore të Bashkisë Fier, sjellë nga subjekti pas ankimit, sipas së cilës aktet janë zhdukur gjatë vitit 1997, subjekti nuk arriti të shpjegojë mungesën e tyre [akteve] për vitet vijues 1998-2001.

8.15. Në konsideratë të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka detyrimin që të provojë se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentet që provojnë burimet e ligjshme, duke vërtetuar se ata janë zhdukur, kanë humbur, nuk mund të bëhen përsëri ose nuk merren në rrugë tjetër. Edhe heshtja në kthimin e përgjigjes nga DPT-ja, paraqitet dukshëm si një rrethanë e derivuar nga gjuha e fjalisë së fundit të kësaj dispozite për të diktuar konstatimin e pamundësisë objektive nga organet e rivlerësimit³⁸. Pretendimet e subjektit për pamundësinë objektive, mbështetur, ndër të tjera, edhe në analizën e komisionerit në pakicë, duket se bazohen kryekëput në shkresat e Drejtorisë së Taksave Vendore të Bashkisë Fier, dërguar babait të saj në vitin 2020 dhe Komisionit në vitin 2021. Duke përdorur si argumentin kryesor përmbajtjen e këtyre shkresave, konfirmuar edhe në deklaratat noteriale të hartuara gjatë procesit për të argumentuar të njëjtat fakte, subjekti potencon se shitësit ambulantë kanë pasur vetëm detyrimin për të paguar *biletën për vendin* ku janë vendosur. *Së fundmi*, këtë pretendim, subjekti është përpjekur ta përmbushë edhe nëpërmjet shkresës së sjellë me ankimin, po nga Drejtoria e Taksave Vendore të Bashkisë Fier, e cila referon zhdukjen e akteve gjatë trazirave të vitit 1997. Subjekti kërkon që këto akte dhe deklaratat noteriale të pranohen si fillim prove me shkresë³⁹.

8.16. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se si arsyetimi i subjektit, edhe ai i komisionerit në pakicë, bazohen në një interpretim të gabuar të kuadrit ligjor në fuqi për kohën, artikulluar nga shkresat e Drejtorisë së Tatimeve Vendore të Bashkisë Fier e ripërsëritur në vijim. Konkretisht, sikurse elaboruar gjerësisht nga Kolegji në vendime të mëparshme⁴⁰ dhe referuar edhe nga shumica e Komisionit, personat fizikë, përfshirë edhe tregtarët ambulantë, mbanin detyrimin të paguanin tatim vjetor me tarifë fikse që në vitin 1993 në zbatim të ligjit nr. 7679/1993. Në të dy shkresat e administruara në hetimin administrativ për subjektin⁴¹, pa referuar *asnjë* bazë ligjore, ky institucion shprehet se tregtarët ambulantë për vitet 1993-2001 *nuk kanë pasur detyrim të regjistrohesh në Bashki, por kanë paguar biletë ditore për zënien e vendit ku ushtrojnë aktivitet.*

³⁸ Dy fjalitë e fundit të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 parashikojnë që: “[...] Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.[...]”

³⁹ Neni 233i Kodit të Procedurës Civile, parashikon rastet e lejimit të provës me dëshmitarë, si vijon: Rregullat e caktuara në dy nenet e mësipërme nuk zbatohen dhe lejohet prova me dëshmitarë: a) kur dokumenti që kërkohet nga ligji për vlefshmërinë ose provimin e veprimit juridik ka humbur ose është prishur pa fajin e palës; b) kur ka një fillim prove me shkresë. Quhet fillim prove me shkresë çdo shkresë, që rrjedh nga ai, kundrejt të cilit drejtohet kërkimi dhe nga përmbajtja e së cilës del se fakti i pretenduar është pothuajse i vërtetë; c) kur veprimi juridik i bërë me shkresë është kryer: - në kundërshtim me ligjin, në mashtrim të ligjit; - nën ndikimin e mashtrimit, kanosjes, ose për shkak të një marrëveshje me keqbesim të bërë midis përfaqësuesit të njërit palë dhe palës tjetër; - nën ndikimin e nevojës së madhe të palës; ç) kur për shkak të rrethanave në të cilat është kryer veprimi juridik ose të marrëdhënieve të posaçme të palëve, nuk ka qenë e mundur të merrej prova me shkresë”.

⁴⁰ Vendimi i Kolegjit (JR) nr. 21/2020, për subjektin e rivlerësimit Roland Jaupaj.

⁴¹ Shkresat nr. {***} prot., datë 11.12.2020 dhe nr. {***} prot., datë 22.04.2021, të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Fier, dërguar përkatësisht babait të subjektit dhe Komisionit.

Po ashtu, pasi referon mungesë arkive e regjistri për kohën kur kërkohen të dhënat, ky institucion shprehet se sistemi elektronik i të dhënave që operon (më së paku në vitet 2020 dhe 2021) është krijuar vetëm në vitin 2016 (sistemi *TAIS*).

8.17. Nën dritën e parashikimeve ligjore të kohës për biznesin e vogël, personat fizikë që ushtronin *veprimtari private të pavarur me qëllime fitimprurëse në tregti*, etj., i nënshtroheshin tatimit mbi të ardhurat që realizojnë, paguanin tatim vjetor me kuotë fikse që përlllogaritej dhe caktohej nga organet tatimore të pushtetit vendor brenda muajit janar për çdo vit tatimor, mbështetur në deklaratën vjetore parashikuese të bërë nga tatimpaguesi dhe verifikime të bëra nga punonjësit e organeve tatimore⁴². Nëse subjektet e këtij ligji nuk mbanin dokumentet për të ardhurat e realizuara, nëse nuk paraqisnin deklaratën për të ardhurat e realizuara dhe nëse nuk derdhnin në afatin e caktuar tatimin mbi të ardhurat, konsiderohej se kishin kryer shkelje, për të cilën parashikohej edhe gjoba përkatëse⁴³. Po ashtu, në rregullimet e mëpasshme në vitin 1998⁴⁴, kategoria “E” e tatimpaguesve, përfshinte në pikën 1 edhe *shitësit ambulante*, të cilët duhet të paguanin një kuotë fikse, në varësi të qytetit në të cilin ushtronin aktivitetin⁴⁵. Subjekte të kuotës fikse ishin ata subjekte që realizonin qarkullim *deri në 2.000.000 lekë në vit*⁴⁶. Ky ligj, po ashtu, në nenin 4 sanksionon përgjegjësinë e tyre për regjistrim në zyrën e tatimeve. Po ashtu, edhe në ligjin nr. 7777, datë 22.12.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, në fuqi në kohën në fjalë, parashikohej si taksë lokale: “*a) taksa e regjistrimit për veprimtari të ndryshme caktohet si më poshtë: [...] për veprimtaritë private të personave fizikë që bëjnë tregti e kryejnë shërbime ambulante – 1000 lekë*”.

8.18. Për sa më sipër, ndryshe nga sa pretendon subjekti, detyrimi i regjistrimit të shitësve ambulante nuk rezulton të ketë lindur vetëm me ligjin nr. 9632/2006. Shitësit ambulante kanë pasur detyrimin ligjor që prej vitit 1993 të regjistroheshin dhe të paguanin taksë lokale, tatimin vjetor me kuotë fikse në bashkinë/rrrethin që ushtronin aktivitetin [mbështetur në deklaratën vjetore parashikuese për qarkullimin deri në 2 milion lekë] dhe detyrimin e regjistrimit dhe pagimit të taksës vendore 1.000 lekë për tregtinë/shërbimet ambulante. Nga aktet në dosje, nuk provohet se prindërit e subjektit kanë qenë të regjistruar apo nëse kanë paguar kuotën fikse të aktivitetit tregtar të tyre. Ky fakt nuk u konfirmua as nga administrata tatimore e Bashkisë Fier.

8.19. Në këto kushte, shkresa e Drejtorisë së Taksave pranë Bashkisë Fier apo deklaratat noteriale, që të konsiderohen se përbëjnë fillim prove me shkresë, duhet të ishin lëshuar nga organi që ka detyrimin e ruajtjes dhe mbajtjes së dokumentacionit [taksave], konkretisht nga Bashkia Fier ose Drejtoria Rajonale Tatimore Fier. Po ashtu, deklaratat noteriale të hartuara gjatë procesit tentojnë të provojnë një situatë juridike që sipas ligjit i përket organeve shtetërore. Për rrjedhojë, vlera e tyre provuese kufizohet vetëm në aspektin e ushtrimit *de facto* të aktivitetit të shitjes ambulante nga prindërit e subjektit. Në këto kushte, konsiderohet i drejtë vlerësimi i Komisionit që deklaratat noteriale të palëve mbeten në nivel deklarativ, në drejtim të provueshmërisë së vlerës së krijuar, ashtu sikurse edhe të lidhjes së të ardhurave të krijuara, me huan e dhënë subjektit në vitin 2016.

8.20. Nga ana tjetër dhe ç’është më e rëndësishme, pavarësisht mungesës së arkivës së institucionit, edhe pa vënë në dyshim ushtrimin e aktivitetit të prindërve, në asnjë akt të kohës

⁴² Ligji nr. 7679/1993 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, nenet 1, 4 dhe 5.

⁴³ Po aty, nenet 8 dhe 9.

⁴⁴ Me ligjin nr. 8313, datë 26.03.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

⁴⁵ Tregtim e shërbim ambulator.

⁴⁶ Neni 3.

nuk provohen të ardhurat në ndonjë nivel sasior, qoftë edhe të ndryshëm nga vlera 56.000 USD e depozituar në bankë në vitin 2003. Fondet që janë dokumentuar në llogaritë bankare të prindërve të subjektit nuk pasqyrojnë në asnjë formë prejardhjen e tyre nga asnjë nga burimet e referuara nga subjekti nga aktiviteti tregtar i pretenduar, sikurse as edhe ligjshmërinë e tyre, në vijim të kritereve të sipër-referuara. Sa më lart, duke qenë se subjekti nuk ka arritur të provojë se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive të sigurimit të dokumentacionit për të provuar të ardhurat, sipas pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, mospërfshirja në analizën financiare të këtyre të ardhurave nga Komisioni është e drejtë.

8.21. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, në analizën më favorizuese të mundshme, më së paku nuk dokumentohet një vlerë të ardhurash të gjeneruara. Në këto kushte, përjashtohet edhe teorikisht mundësia për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave që mund të jenë gjeneruar nga ky aktivitet, nën dritën e përcaktimit të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Deklaratat e paraqitura nga subjekti, konfirmimet e balancave bankare apo aktet e tjera të paraqitura nuk provojnë nivelin e të ardhurave të gjeneruara nga prindërit e subjektit nga aktiviteti i shitjes ambulante, por as lidhjen midis të ardhurave të dhuruara dhe aktivitetit të pretenduar të shitjes ambulante të prindërve të subjektit me vlerën e dhënë hua që shërbeu si burim i krijimit të pasurisë. Për këtë arsye, konkludohet se subjekti dhe personat e tjerë të lidhur nuk arritën të provojnë mundësinë e financimit të huas nga aktiviteti i pretenduar i shitjes ambulante.

8.22. Burimi tjetër që ka shërbyer për huan, referuar kontratës, janë të ardhurat e prindërve të subjektit nga shitja e një apartamenti në Fier në vitin 2001 dhe një apartamenti në Tiranë në vitin 2005. Nga këto dy transaksione, subjekti ka deklaruar se prindërit kanë gjeneruar 2.500.000 lekë⁴⁷. Në vitin 2006, prindërit e subjektit kanë blerë një apartament tjetër në Tiranë në vlerën 19.800 euro. Në këtë apartament ka jetuar subjekti së bashku me bashkëshortin dhe prindërit e saj⁴⁸ deri në vitin 2016. Komisioni konkludoi se nuk provohet që prindërit e subjektit kanë pasur likuiditete gjendje për dhënien e huas, referuar shitblerjeve të pronave të paluajtshme, pasi të ardhurat e përfituara janë ri-investuar në blerjen e pasurive të tjera të paluajtshme⁴⁹. Sipas Komisionit, fragmentimi që i bëri subjekti shitblerjeve të pronave të paluajtshme nga prindërit e saj, duke u ndalur te shitja e apartamentit të parë në Tiranë, pa marrë në konsideratë se pas shitjes së tij prindërit blenë një apartament tjetër po në Tiranë, nuk provon se ata kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar pasuritë likuiditete, dhënë hua subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, në analizën financiare të prindërve të subjektit, Komisioni ka përfshirë edhe shpenzimet e investimit të vlerës 19.800 euro për blerjen e apartamentit në Tiranë.

8.23. Subjekti kundërshton sa më sipër, duke e quajtur qëndrim hipotetik atë të mbajtur nga Komisioni dhe kërkon që në analizë të përfshihen të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurive

⁴⁷ Sikurse referuar edhe në hyrje të këtij vendimi, prindërit e subjektit kanë pasur në pronësi një apartament banimi në Fier, të blerë në vitin 1993, shitur në vitin 2001, në vlerën 1.500.000 lekë. Në datën 18.01.2002, ata kanë blerë një apartament në Tiranë, kundrejt çmimit 1.000.000 lekë. Në pyetësorin nr. 2, subjekti është shprehur se apartamentit në Tiranë është financuar nga shitja e apartamentit në Fier. Nga ky transaksion, sipas saj, prindërit kanë krijuar likuiditete nga shitja dhe blerja e apartamenteve me sipër në vlerën 500.000 lekë [si diferencë e çmimit të shitjes së apartamentit në Fier me çmimin e blerjes së apartamentit në Tiranë]. Apartamentin e blerë në janar 2002 në Tiranë, e kanë shitur në vitin 2005 në vlerën 2.000.000 lekë.

⁴⁸ Sipas deklarimeve të subjektit në përgjigjet e pyetësorit nr. 1.

⁴⁹ Komisioni ka arritur në përfundimin se, në raport me legjislacionin e zbatueshëm, në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status, subjekti nuk ka arritur të provojë me asnjë dokumentacion ligjor provues se si burim krijimi i huas së dhënë në shumën 36.000 euro në vitin 2016 kanë shërbyer të ardhura të përfituara nga prindërit nga shitblerjet e pronave.

të paluajtshme të prindërve në shumën totale prej 2.500.000 lekësh, si burim për krijimin e huas 36.000 euro, sikurse është deklaruar prej saj. Duke gjykuar mbi mënyrën e përdorimit të të ardhurave nga shitja e apartamenteve nga prindërit e saj, Komisioni ka dalë përtej qëllimit të parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, potencon subjekti. Komisioni duhej të kufizohej vetëm në pyetjen nëse janë realizuar të ardhura nga shitja e dy pasurive të paluajtshme dhe nëse janë paguar detyrimet tatimore për to, në funksion dhe si burim i deklaruar i huas.

8.24. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 pretendimin e subjektit. Edhe në analizën e kryer në Kolegj, në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit mbi bazën e shkaqeve të ankimit, analiza financiare e prindërve të subjektit u kufizua në vlerën e kontributit të tyre në drejtim të krijimit të pasurive të subjektit. Me fjalë të tjera, në analizën e kryer në Kolegj për prindërit/personat e tjerë të lidhur me subjektin nuk u përfshinë investimet e tyre për blerjen e apartamentit në vitin 2006, në Tiranë. Ky qëndrim është në linjë me praktikën e Kolegjit⁵⁰ në çështje të mëparshme, që analiza financiare e burimeve të ligjshme të personave të tjerë të lidhur të kufizohet brenda pasurisë/ve objekt dhurimi ose huaje. Po në vijim të orientimit të Kolegjit, pjesë e kësaj analize do të duhet të ishin edhe shpenzimet e jetesës së personave të tjerë të lidhur. Në përputhje të përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, kjo mënyrë verifikimi vlerësohet e arsyeshme dhe proporcionale, pasi krijon një panoramë të drejtë nga e cila mund të deduktohet për mundësinë e personave të tjerë të lidhur për të kontribuar për krijimin e pasurive nga subjektet e rivlerësimit, pa krijuar një sfidë të pamundur e të padrejtë, siç do të ishte kontrolli i gjithë pasurive e investimeve të personave të tjerë të lidhur, për sa kohë – si në rastin konkret – nuk është në diskutim fshehje pasurie e subjekteve.

8.25. Po ashtu, gjatë hetimit administrativ⁵¹, subjekti ka pretenduar se të ardhurat nga aktiviteti kanë qenë depozituar në emër të babait të saj në Bankën Amerikane të Shqipërisë. Komisioni nuk i mori në konsideratë fondet e tërhequra në vitin 2004 nga llogaritë bankare të të atit kundrejt huas së dhënë subjektit. Komisioni arsyetoi se subjekti i rivlerësimit dështoi të bindte trupin gjykues se huaja e kishte burimin pikërisht nga fondet/të ardhurat që ndodheshin në bankë rreth 12 vjet më herët, sikurse edhe për to nuk provohej as pagesa e detyrimeve tatimore.

8.26. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar vlerësimin e Komisionit për këtë aspekt. Depozitimi i vlerës 56.000 USD në bankë në vitin 2003 nuk shoqërohet me asnjë indicie apo akt të kohës për ta lidhur me aktivitetin tregtar të prindërve. Ajo që është më e rëndësishme në rrethanat konkrete, fakti që babai i subjektit i ka tërhequr këto fonde nga banka brenda një kohe shumë të shkurtër [tetor 2003 -- shkurt 2004] apo pretendimi që u mbajtën në shtëpi në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, nga viti 2004 deri në vitin 2016, kur i përfitoi subjekti për të shlyer kredinë, u vlerësuan edhe nga trupi gjykues si pretendime me probleme besueshmërie, për një sërë arsyesh.

8.27. *Së pari*, nga aktet në fashikull, rezulton se prindërit e subjektit në vitin 2010 morën kredi konsumatore me vlerë 100.000 lekë, të cilën e shlyen rregullisht për tre vjet edhe duke paguar në total 24.285 lekë interesa bankare. Ky detyrim financiar me interesat e larta mujore, për një shumë modeste, nuk duket i besueshëm përkundër pretendimit që ndërkohë ata dispononin një sasi të konsiderueshme likuiditetesh në banesë. Marrja e kësaj kredie nga prindërit e përforcon

⁵⁰ Shih ndër të tjerë: vendimet e Kolegjit (JR) nr. 15/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Rreshka dhe (JR) nr. 2/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Toro.

⁵¹ Pyetësori nr. 2.

bindjen se vlera e dhuruar nuk ka ekzistuar në familjen e subjektit në gjendjen *cash*, pasi do të përjashtonte nevojën e tyre për të marrë kredi konsumatore me vlerë kaq të ulët. Po ashtu, fondet e depozituara në institucionet e ndryshme bankare, të cilat referohen si zanafilla e vlerës që më pas është dhënë hua, i përkasin viteve 2003 dhe 2004, ndërsa depozitimi i vlerës në *cash* nga personi tjetër i lidhur, babai i subjektit në datën 23.06.2016, në funksion të materializimit të kësaj huaje, i përket fundit të vitit 2016 e fillimi i vitit 2017.

8.28. *Së dyti*, distanca e gjatë kohore, prej mbi 10 vjetësh, mes gjurmëve të fundit dokumentare të këtyre fondeve në dispozicion të personave të tjerë të lidhur, me momentin kur është kryer depozitimi i vlerës së dhënë hua në *cash* në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, u vlerësua nga trupi gjykues i Kolegjit si aspekt që cenon besueshmërinë e vijimësisë së ekzistencës së këtyre të ardhurave. Për rrjedhojë, u vlerësua jo vetëm i paprovuar, por edhe jobindës pretendimi i subjektit se personat e tjerë të lidhur/prindërit kanë ruajtur në *cash*, jashtë sistemit bankar, një sasi të konsiderueshme likuiditetesh, të paprekur e të papërdorur për 12/13 vjet për t'ia dhënë ato më pas subjektit pa afat, materializuar me kontratën e huas në fillim të vitit 2017, përpara plotësimi të deklaratës *vetting*, pavarësisht nevojave të tyre financiare. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit mbajti në konsideratë, ndër të tjera, edhe që i vetmi anëtar i familjes së origjinës së subjektit që rezultoi i punësuar në mënyrë të vazhdueshme deri në vitin 2014 ishte i ati, punonjës i paguar nga buxheti i shtetit. Në vitin 2014, situata financiare duhet të ketë ndryshuar, pasi ai ka dalë në pension. Po ashtu, sikurse referuar më sipër, në vitin 2010, prindërit e subjektit e kanë pasur të nevojshme për të kërkuar kredi konsumatore për 100.000 lekë, të cilën e kanë shlyer deri në vitin 2013. Në këto kushte dhe duke abstraguuar nga fakti që prindërit e subjektit kanë edhe detyrime të tjera financiare familjare, pretendimi se prindërit kishin mjaftueshëm fonde/likuiditete, të cilat nuk i përdornin për nevojat e tyre, por ia vunë subjektit në dispozicion për t'i përdorur për t'i kthyer "pa caktuar një afat kohor", u vlerësuan të pabesueshme në kontekstin në tërësi të këtyre aspekteve.

8.29. Komisioni nuk përfshiu në analizë financiare të prindërve të subjektit të ardhura nga punësimi në emigracion, në funksion të përlllogaritjes së mundësisë për krijimin e vlerës së huas. Vetë subjekti ka shpjeguar se këto të ardhura janë realizuar nga puna në *sezone verore*, kur nuk ka qenë i siguruar⁵². Në ankim, subjekti shprehet se flitet për të ardhura që zënë një peshë minimale, të pakonsiderueshme në totalin e shumës së dhënë hua, por shërbyen si burim për krijimin e vlerës 36.000 euro të dhënë hua e, si të tilla, duhet të përfshihen në analizë.

8.30. Nën dritën e testit të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit thekson se edhe teorikisht ky zë të ardhurash nuk përmbush këto kriteret, përpos që subjekti nuk ka saktësuar as një vlerë të tyre. Për rrjedhojë, sikurse Komisioni, edhe Kolegji e çmon të panevojshme të ndalet në arsyetim më të zgjeruar të këtij aspekti të të ardhurave të pretenduara.

8.31. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konfirmon mungesën e burimeve të ligjshme të personave të tjerë të lidhur/prindërve të subjektit për të kontribuar me huan në vlerën 36.000 euro, në funksion të krijimit të pasurisë objekt ankimi. Sikurse edhe subjekti, trupi gjykues prezumon se për shumicën e Komisionit duhet të jetë konfirmuar balanca negative e rezultateve të hetimit prej (-) 5.245.597 lekësh, për të financuar huan dhe mbuluar shpenzimet e investimet e prindërve ndër vite. Në kontrollin e kryer në Kolegji mbi metodologjinë e Komisionit, në analizën financiare të prindërve nuk u përfshinë investimet për

⁵² Përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

blerjen e apartamentit në vitin 2006, në përputhje me arsyetimin e mësipërm e jurisprudencën e Kolegjit. Pavarësisht nga ky korrektim, balanca negative që u përftua në analizën financiare në Kolegj është e konsiderueshme, në vlerën (-) 2.477.560 lekë, edhe pa përfshirë shpenzimet e jetesës për harkun kohor 1993-2001 – që, sipas subjektit, i përkon kohës kur janë krijuar të ardhurat. Nëse në këtë vlerë do të përlllogariteshin shpenzime jetese, sërish në linjë me metodologjinë e zbatuar në mënyrë konsistente në gjithë arsyetimet e mëparshme të Kolegjit, e që Komisioni nuk rezulton ta ketë ndjekur, balanca negative do të thellohej, duke arritur në vlerën (-) 4.912.120 lekë.

8.32. Nën dritën e garancive procedurale me ankimin, ky konstatim u mbajt në konsideratë me rezervë, meqenëse subjekti është njohur dhe ka parashtruar pretendime për një vlerë më të lartë, por për shkak zërash financiarë të ndryshëm. Pavarësisht nga ky qëndrim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe balanca negative e reduktuar, pas zbritjes së investimeve, është në një vlerë të konsiderueshme, sidomos nëse sillet në vëmendje niveli i pagave në vitet në fjalë, 1993-2001, dhe ndryshimet e tjera të natyrës politike e financiare që ka kaluar Shqipëria në kohën në fjalë që kanë pasur pasoja drastike në vlerën e monedhës zyrtare dhe në treguesit ekonomikë të vendit në përgjithësi⁵³.

8.33. Burimi i fundit i krijimit të pasurisë është një vlerë prej 2.000 eurosh. Komisioni konkludoi se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi të paguajnë këstin e fundit të apartamentit prej 2.000 eurosh në datën 24.08.2016, pasi nga analiza financiare e kryer për periudhën 01.01.2016-24.08.2016, ka rezultuar një bilanc negativ në vlerën (-) 636.224 lekë. Sipas Komisionit, pretendimi i subjektit se tepricat financiare të viteve 2012, 2013 dhe 2014 nuk janë deklaruar si kursime, por as nuk janë shpenzuar në sajë të jetesës me prindërit dhe administrimit prej këtyre të fundit të të ardhurave, nuk mbështetet as në deklaratimet e babait të subjektit. Në analizën e të ardhurave të bashkëshortit, për periudhën deri më 24.08.2016, Komisioni ka përfshirë vetëm kreditimet që përmbajnë në përshkrim përcaktimin “pagë”, në vlerën 427.414 lekë.

8.34. Subjekti kundërshton përfundimet e Komisionit, duke pretenduar se ato përbëjnë interpretim të gabuar të shpjegimeve të saj gjatë hetimit administrativ. Ajo thekson se nuk ka pretenduar se kësti i fundit [vlera 2.000 euro] i apartamentit është shlyer me kursimet familjare të viteve 2012-2014⁵⁴, por se shpenzimet e jetesës janë përballuar prej kursimeve familjare, duke krijuar mundësi kursimi të ardhurash në këtë vlerë për subjektin dhe bashkëshortin. Prindërit nuk ishin subjekte deklarues, potencon subjekti. Gjithashtu, subjekti kërkon që të përfshihen në mesin e të ardhurave kreditimet e bashkëshortit nga dietat dhe shpërblimet, të dokumentuara nga aktet bankare. Këto pretendime ajo i ka pasqyruar edhe në një formë tabelare, duke potencuar balancë pozitive të dukshme [(+) 1.559.119 lekë] deri në datën 24.08.2016, kur është paguar kësti i apartamentit.

8.35. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimi i subjektit për të përlllogaritur kursime shtesë, të

⁵³ Referuar gjerësisht në vendime të mëparshme të Kolegjit, përfshirë edhe në paragrafin nr. 23.14 të vendimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Brati (JR) nr. 14/2019: “[...] Konkretisht, përkundër pretendimit të subjektit dhe arsyetimit të kryer në Komision, trupi gjykues vëren se të ardhurat e përfituara nga individët në Shqipëri deri në vitin 1992, për shkak të krizës drastike financiare që kaloi vendi atë vit për shkak të ndryshimeve të natyrës politike, janë të papërfillshme për shkak të inflacionit deri në 400 për qind (%) që kaloi ekonomia shqiptare. [...]”.

⁵⁴ Duket sikur subjekti i referohet shumës së balancave pozitive të rezultuara nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitet 2012-2014.

padeklaruar përpas se të kryhej hetimi administrativ, është i pabazuar. Për rrjedhojë, edhe në analizën e kryer në Kolegj, për efekt të kontrollit të vendimit të Komisionit, u mor në konsideratë burimi i deklaruar prej subjektit në deklaratën *vetting* dhe atë të vitit 2016 – pagat deri në gusht të vitit 2016. Nga ana tjetër, edhe pasi Kolegji përllogariti *gjithë* kreditimet në llogarinë e pagës së bashkëshortit të subjektit, me përjashtim të atyre që kanë përshkrimin “dieta”, subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti, rezultojnë gjithsesi me pamundësi për të përballuar shlyerjen e këstit të fundit [2.000 euro] dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera. Balanca negative që përftohet nga analiza e kryer në Kolegj, nëse ndihet metodologjia e Komisionit zbutet në një vlerë të papërfillshme, krahasuar me Komisionin e konkretisht, nga (-) 636.224 lekë në (-) 613.224 lekë. Në variantin në të cilin shpenzimet dhe të ardhurat do të përllogaritheshin sipas certifikatës familjare [subjekti, bashkëshorti dhe fëmija i tyre], balanca negative zbutet në mënyrë të konsiderueshme krahasuar me atë në Komision, por gjithsesi mbetet e pranishme: nga (-) 636.224 lekë në Komision, në (-) 322.827 lekë sipas korrektimit. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

8.36. Subjekti ka ankimuar analizën e kryer nga Komisioni vetëm për zërat “Të ardhura nga pagat e bashkëshortit” dhe “Mundësia për kursim deri më 01.01.2016”. Referuar këtij të fundit, subjekti pretendon kursime, të cilat i cilëson si *të padeklaruar, por as të shpenzuara të administruara nga prindërit*. Duke mbajtur në konsideratë këto dy zëra si bazë e shkaqeve të ankimit për këtë aspekt të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje, *së pari*, që sipas deklarimeve ndër vite në ILDKPKI, rezulton se subjekti është shkëputur nga certifikata familjare e prindërve që në vitin 2014⁵⁵, por ka vazhduar të deklarojë shtëpinë e tyre si adresë banimi, përfshirë edhe deklaratën periodike për vitin 2015 [dorëzuar në mars 2016]. Në deklaratën periodike për vitin 2016, si edhe në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar si adresë banimi apartamentin e ri, objekt analize, të blerë në gusht 2016.

8.37. Nga aktet në fashikull, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash* jashtë sistemit bankar, përveç vitit 2015. Në këtë të fundit, subjekti deklaroi 200.000 lekë kursime, nga paga e saj dhe e bashkëshortit. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, subjekti deklaroi *pakësim të kursimit të deklaruar në vitin 2015 në masën 200.000 lekë*, përdorur për shlyerjen e pjesës së mbetur të kredisë *personale* të bashkëshortit, sipas kontratës së datës 18.01.2012. Në të njëjtën deklaratë, subjekti deklaroi edhe kursimin e 150.000 lekë nga paga e saj dhe e bashkëshortit.

8.38. Në deklaratën *vetting* dhe në atë për vitin 2016, subjekti ka deklaruar në mënyrë të shprehur se pagesa në fjalë është krijuar *me të ardhurat nga paga personale dhe e bashkëshortit në vitin 2016*. Përkundër këtyre deklarimeve specifike, në ankim, subjekti pretendon se tepricat i ka përdorur si *shpenzime* të jetesës së përbashkët dhe jo për shlyerjen e këstit të fundit të apartamentit. Edhe trupi gjykues i Kolegjit, një linjë me Komisionin, i gjen të pabesueshme pretendimet e subjektit të sjella rishtazi, për *teprica* të krijuara gjatë jetesës më prindërit e të administruara prej tyre, të cilat nuk i ka deklaruar. Këto pretendime bien ndesh me deklaratat e kryera nën përgjegjësi ligjore, konkretisht ato në deklaratën *vetting* apo në deklaratat periodike vjetore, të cilat në rivlerësim kanë peshën e provës, sipas pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Deklarimet gjatë procesit administrativ vlerësohen si përpjekje për t’iu përshtatur situatës ligjore më shumë sesa realitetit.

⁵⁵ Që prej vitit 2014, subjekti figuron në certifikatë familjare me bashkëshortin dhe vajzën.

8.39. Ndërsa nga aktet provohet pretendimi i subjektit për jetesën në banesën e prindërve, minimalisht deri në vitin 2015, nuk mund të provohet se kjo jetesë përfshinte edhe aspektet e jetës financiare të të gjithë familjes. Komisioni ka marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësorëve, lidhur me qëndrimin në një ekonomi familjare me prindërit, duke përfshirë në analizë të ardhura dhe shpenzime që i përkasin edhe prindërve dhe motrës së subjektit. Me fjalë të tjera, Komisioni ka zgjedhur ta pranojë këtë pretendim të subjektit, duke krijuar në këtë mënyrë një situatë në të cilën prindërit e subjektit efektivisht janë përlllogaritur si persona të lidhur, e jo të tjerë të lidhur, pavarësisht certifikatës familjare që sugjeron ndryshe dhe faktit që këtë cilësim Komisioni nuk e ka kryer. Ky qëndrim i Komisionit bie ndesh me deklaratimet e subjektit në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, sikurse edhe me aktet për shërbimet utilitare, ndër të tjera, nga të cilët rezulton një situatë që konfirmon deklarin e subjektit për lëvizjen në apartamentin e ri, i cili duhet të ketë qenë i gatshëm për banim duke nisur nga vjeshta 2016⁵⁶.

8.40. Pavarësisht nga ky konstatim, nën dritën e garancive procedurale me ankimin, trupi gjykues i Kolegjit analizoi shkaqet e ankimit, duke u bazuar në qëndrimin e Komisionit. Nga kjo analizë, bazuar në faktin se burimi i deklaruar nga subjekti në deklaratën *vetting*, për këstin prej 2.000 euro, janë vetëm të ardhurat e saj dhe bashkëshortit nga pagat e vitit 2016, në Kolegj u krye analiza financiare në variantin e Komisionit, sikurse edhe atë të bazuar në certifikatën familjare, për tre anëtarë. Ky variant i dytë u vlerësua i nevojshëm për të krijuar një panoramë më të plotë dhe shtuar të gjitha çështjet që lidhen me krijimin e kësaj pasurie. Në këto analiza, sikurse në Komision, edhe në Kolegj, kursimet *cash* të padeklaruar e pretenduara të *mbartura*, për shkak të bashkëjetesës me familjen e saj të origjinës, nuk u morën në konsideratë, nën dritën e përcaktimit të shprehur të ligjit nr. 9049/2003 dhe vlerës provuese që përftojnë deklaratat periodike në procesin e rivlerësimit. E thënë ndryshe, në kushtet kur këto kursime apo *teprica*, siç i cilëson subjekti, nuk kanë gjetur pasqyrim në deklaratat periodike, në linjë me vendime të mëparshme të Kolegjit, ato nuk mund të përfshiheshin në analizë pas pretendimit për ekzistencën e tyre gjatë procesit të hetimit administrativ⁵⁷.

8.41. Për sa më sipër, duke përlllogaritur burimet për shlyerjen e këstit të fundit të apartamentit të banimit prej 200.000 lekësh, sipas deklaratës *vetting* dhe deklaratës periodike për vitin 2016 [hartuar në mars 2017], nga pakësimi i gjendjes *cash* nga viti i mëparshëm dhe duke përlllogaritur vetëm pagat e subjektit dhe të bashkëshortit, analiza e kryer në Kolegj konfirmon balancën negative të përlllogaritur në Komision, edhe pas korrektiveve për kreditimet e pagës së bashkëshortit të subjektit. Në këtë analizë u përlllogarit edhe shlyerja në qershor 2016 e një kredie personale të marrë nga bashkëshorti i subjektit⁵⁸. Në alternativën e kësaj analize, sipas certifikatës familjare, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, situata financiare e subjektit dhe personit të lidhur për të përballuar këstin e fundit do të përmirësohej dukshëm, por nuk

⁵⁶ Subjekti ka dorëzuar në Komision një mandatarkëtim për ndryshimin e emrit të abonentit të shërbimit të furnizimit me energji elektrike në apartamentin e saj, që është i datës 18.10.2016, ashtu sikurse edhe dy fatura tatimore të OSHEE-së që janë të muajve shtator-tetor 2016. Subjekti ka paraqitur edhe akt dorëzimi apartamenti, që mban datën 04.10.2016, nga ndërtuesi në të cilin është shënuar "të mbarohen menjëherë punimet e mbetura". Ndërsa në procesverbalin e marrjes në dorëzim të të njëjtës datë, nënshkruar nga bashkëshorti i subjektit, është shënuar se "punimet janë në rregull".

⁵⁷ Shih, ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit në çështjen e subjektit të rivlerësimit Edmond Islamaj (JR) nr. 11/2019, Xhezair Zaganjori (JR) nr. 19/2019, Dritan Peka (JR) nr. 27/2020 dhe Erjon Pano (JR) nr. 14/2024.

⁵⁸ Sipas shkresës së Raiffeisen Bank, administruar në Komision, bashkëshorti i subjektit ka pasur edhe një kredi personale bankare të disbursuar në vitin 2012, me vlerë 500.000 lekë, e cila është shlyer plotësisht në datën 07.06.2016. Kësti i kredisë së paguar nga subjekti dhe personi i lidhur për këtë detyrim përgjatë vitit 2016, deri në mbylljen e saj, është në vlerën 303.971 lekë.

përmbysset, pasi rezulton gjithsesi me balancë negative. Konkretisht, balanca negative e korrigjuar e Komisionit, në alternativën e kryer sipas certifikatës familjare, do të reduktohej nga (-) 613.724 lekë në (-) 322.827 lekë.

8.42. Në analizën e mësipërme financiare, ndër kreditimet e kryera për efekt të të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i subjektit, trupi gjykues i Kolegjit përlllogarit pagën *neto* të fituar prej tij deri në datën 24.08.2016 [data e nënshkrimit të kontratës të shitblerjes⁵⁹], që përlllogaritet në vlerën 470.414 lekë⁶⁰, me një shtesë kundrejt përlllogaritjes së Komisionit në vlerën 427.414 lekë – nisur nga përshkrimi strikt i kreditimeve. Subjekti ka kërkuar që në të ardhurat e bashkëshortit të përfshihet çdo e hyrë në sistemin bankar duhet konsideruar “e ardhur”, për sa kohë ajo mund të disponohet në momentin e përfitimit të saj pa afektuar analizën financiare të viteve paraardhëse, përfshirë dietat, shpërblimet dhe shpenzimet e uniformës nga {***}.

8.43. Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare dietat, pasi ato përbëjnë kontribut të punëdhënësit për shpenzime ditore të kryera gjatë shërbimit. Përpos sa është elaboruar gjerësisht për faktin që dietat përbëjnë kontribut për shpenzime që janë kryer, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në aktet pjesë e fashikullit, përfitimet përpos pagës pasqyrohen si shumatore e gjithë vitit⁶¹, duke e bërë të pamundur të përlllogaritet në çfarë përqindjeje këto mbështetje financiare të punëdhënësit janë lëvruar deri në gusht kur është kryer pagesa. Për rrjedhojë, gjatë kontrollit të analizës së Komisionit, dhe duke ndjekur qasjen e kërkuar nga subjekti për të përlllogaritur gjithë përfitimet që kanë qenë disponuar nga familja deri në momenti e kryerjes së pagesës, trupi gjykues i Kolegjit përlllogarit një vlerë përpjesëtimore të pagës deri në gusht 2016 nga totali i pagës *neto*.

8.44. Për sa më lart, në konkluzion të analizës së pretendimeve të parashtruara në ankim për mundësinë e krijimit të pasurisë objekt analize, nga kontrolli i analizës në Kolegj për këtë pasuri, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj. Subjekti nuk ka justifikuar me dokumentacion, ligjshmërinë e burimit të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e: (i) huas së dhënë nga prindërit në vlerën 36.000 euro; dhe (ii) për pagesën e këstit të fundit prej 2.000 eurosh në datën 24.08.2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur apo personat e tjerë të lidhur janë gjetur në kushtet e mungesës së justifikimit me dokumentacion ligjor të vlerësuar që shërbeu për krijimin e kësaj pasurie, sipas shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

II. Për automjetin tip “Daimler Chrysler”, prodhim i vitit 2003

9. Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar automjetin prodhim të vitit 2003 të tipit “Daimler Chrysler”, me burime të ardhurat nga shitja e një automjeti tjetër në qershor 2015. Në konkluzion, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë dhe ka

⁵⁹ Në bazë të të cilës në datën 29.08.2016, në referim të certifikatës së pronësisë, është paraqitur kërkesa për hipotekim/regjistrim të pronës.

⁶⁰ Nga aktet e depozituara në Komision nga subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, gjendet i administruar një vërtetim ISSH-së, për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, sipas së cilit, ndër të tjera, konfirmohet se i siguruari, personi i lidhur/bashkëshorti, për vitin 2016 ka përfituar paga *neto* në vlerën totale 722.013 lekë. Bazuar në dokumentacioni bankar të administruar në dosje, në llogarinë bankare në Credins Bank të personit të lidhur, për periudhën 01.01.2016-24.08.2016, janë kredituar paga nga {***} në total: 470.414 lekë.

⁶¹ Sipas vërtetimit të lëshuar nga {***}, bashkëshorti i subjektit, në vitin 2016 ka realizuar në total të ardhura në vlerën 722.023 lekë, nga të cilat 600.388 lekë janë të ardhura *neto* nga paga, kurse pjesa tjetër janë dieta e kompensim i veshjes civile.

mungesë burimesh për krijimin e kësaj pasurie. Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk ka deklaruar burimin fillestar financiar që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, pasi nuk ka deklaruar një hua të marrë nga prindërit dhe e ka të pamundur të kuptojë cili është deklarimi i vërtetë. Në përfundim, edhe vetëm konkluzioni për këtë pasuri ka qenë i mjaftueshëm për ta konsideruar subjektin në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të të njëjtit ligj.

9.1. Subjekti pretendon se e ka deklaruar saktë këtë pasuri, ndërsa Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës në relacionin e rezultateve të hetimit për burimin që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie. Huan e marrë nga prindërit, të shlyer brenda vitit me të ardhurat nga pagat e atij viti, e ka deklaruar si burim në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2015 dhe, për pasojë, nuk kishte detyrimin ta deklaronte në deklaratën *vetting*. Në kohën e plotësimit të deklaratës *vetting*, nuk e dispononte automjetin, shitja e të cilit shërbeu si burim. Subjekti pretendon se i vetmi saktësim që ka bërë gjatë hetimit në Komision ishte se shuma e marrë hua ka qenë 100.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 236.000 lekësh ishte krijuar nga kursime të akumuluar të bashkëshortit para martesës, që ai nuk i deklaroi në deklaratën fillestare për shkak të moskuptimit. Burimi i vlerës së dhënë nga prindërit prej 100.000 lekësh, ishte pjesë e vlerës që shërbeu për krijimin e shumës prej 36.000 eurosh. *Së fundmi*, subjekti pretendon se në rezultatet e hetimit Komisioni nuk e ka bërë me dije dhe nuk i ka kaluar barrë prove për mosdeklarimin e burimit fillestar të automjetit.

9.2. Pasi analizoi aktet në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të gabuar konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë, ndërsa njëkohësisht e gjen të bazuar konstatimin për mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Konkretisht, në kushtet që në deklaratën *vetting* subjekti ka referuar qartë e saktë burimin e krijimit -- të ardhurat nga shitja e një automjeti tjetër – dhe që ky transaksion ka ndodhur përpara blerjes së pasurisë objekt analize, konkluzioni i Komisionit që fokusohet në kontradiktat në deklaratimet e vlerës së marrë hua nga babai i subjektit, sipas shpjegimeve gjatë hetimit administrativ, mund/duhet të ishte vlerësuar në drejtim të besueshmërisë së subjektit për vlerën e huas. Nga ana tjetër, në analizën e kryer në Kolegji, sikurse arsyetuar gjerësisht më sipër për pasurinë tjetër [apartament], prindërit e subjektit rezultojnë me pamundësi për të dhënë huan. Për pasojë, edhe në vlerësimin e kryer në Kolegji, subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve për krijimin e kësaj pasurie. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

9.3. Nga aktet në fashikull rezulton se automjeti objekt analize është blerë në dhjetor 2015⁶². Qoftë në *deklaratën periodike* për vitin 2015, qoftë në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si *burim* krijimi shitjen e një automjeti tjetër, të së njëjtës markë, në qershor 2015, dhe përfitimin e vlerës 2.000 euro. Automjeti i shitur në qershor 2015 ishte blerë në janar të të njëjtit vit dhe deklaruar si burim hua nga babai i subjektit në vlerën 336.000 lekë. Në këtë deklaratë, personi i lidhur ka specifikuar se huaja është *shlyer brenda vitit 2015*⁶³. Këto akte konfirmohen edhe nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ⁶⁴.

9.4. Pretendimi i subjektit për moskalim të barrës së provës për atë që Komisioni e ka konsideruar burimin *fillestar* financiar, e konkretisht, huan e financuar nga i ati i saj, është i

⁶² Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.12.2015.

⁶³ Po në këtë deklaratë, në seksionin e të ardhurave, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar të ardhura nga shitja e këtij automjeti në vlerën 2.000 euro.

⁶⁴ Kthim përgjigjeje me nr. {***} prot, datë 11.02.2020, Komisionit nga DPShTRr-ja.

bazuar. Komisioni i ka kaluar barrë prove shprehimisht subjektit për: (i) mungesën e burimeve të ligjshme të mjaftueshme për blerjen në vlerën 336.000 lekë; dhe (ii) mospërputhjen mes deklaramit të bashkëshortit në deklaratën për vitin 2015 për vlerën ekzakte të marrë hua, krahasuar me shpjegimet e subjektit në pyetësorë.

9.5. Në kushtet që gjithë trajektorja e veprimeve financiare që kanë passjellë krijimin e pasurisë së deklaruar në deklaratën *vetting* konfirmohet, arsytimi i Komisionit është i paqartë. E thënë ndryshe, në kushtet që automjeti, për të cilin burim pretendohet huaja nga babai i subjektit, nuk ishte më pasuri e subjektit/personit të lidhur, deklarimi i shitjes së tij si burim për krijimin e automjetit të dytë nuk mund të argumentohet si deformim i së vërtetës, për sa kohë Komisioni nuk ka kontestuar vërtetësinë e veprimeve noteriale të shitblerjes apo vënë në dyshim detaje me rëndësi të tyre.

9.6. Nga ana tjetër, subjekti rezulton e pabesueshme gjatë hetimit administrativ, për sa i përket shumës së marrë hua nga i ati për automjetin e parë të blerë në vitin 2015. Konkretisht, përkundër deklaratës periodike për vitin 2015, ku huaja specifikohet në vlerën 336.000 lekë [totali i shpenzimeve për automjetin në fjalë], duke filluar nga pyetësori nr. 2, subjekti ka pretenduar se huaja në fakt ishte vetëm 100.000 lekë dhe që bashkëshorti kishte kryer një pasaktësi. Subjekti, po ashtu, është shprehur se huaja kishte për burim kursimet e familjes së saj nga shitja ambulante dhe nga shitja e dy apartamenteve (analizuar më lart).

9.7. *Së fundmi*, edhe në analizën financiare të kryer në Kolegj, pasi u përfshinë gjithë të ardhurat e dokumentuara të prindërve, duke zbritur vetëm shpenzimet e jetesës së familjes në vitet 1993-2001 – periudha e konkretizuar nga deklaramit e subjektit nga ku u krijuan të ardhurat për efekt të huas në vlerën 36.000 euro -- trupi gjykues konfirmoi mungesën e burimeve të ligjshme të krijimit të kësaj pasurie, në çfarëdo vlere të përlllogaritet huaja. Konkretisht dhe sikurse referuar më sipër, të ardhurat e dokumentuara të prindërve janë ato të përfituara nga shitja e apartamenteve në Fier e Tiranë, përkatësisht në vitet 2001 dhe 2005, në vlerën 2.500.000 lekë. Shpenzimet jetike, sipas standardit të INSTAT-it, për familjen me pesë (5) anëtarë janë 2.448.440 lekë. Nga kjo shumë, prindërit e subjektit kanë pasur mundësi të kursejnë një shumë minimale prej 51.560 lekësh, pa përfshirë investime të tjera apo shpenzime të dokumentuara.

9.8. Në vlerësimin fundor, pa përsëritur sa është arsyetuar më sipër, këto aspekte u vlerësuan edhe në drejtim të mungesës së besueshmërisë së pretendimeve të subjektit për shuma të konsiderueshme të ruajtura nga prindërit pavarësisht nga nevoja e dokumentuar e tyre për të marrë përsipër detyrime financiare të konsiderueshme ndaj bankës për një vlerë modeste kredie, ndërkohë që babai i subjektit kishte dalë në pension, nga njëra anë, ndërsa subjekti e bashkëshorti ishin të dy të punësuar në mënyrë të vazhdueshme. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konfirmon konkluzionin e Komisionit se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

III. Të ardhurat e personit të lidhur/bashkëshortit nga shitja e një pjese të tokës arë, në Velipojë, Shkodër

- 10.** Në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar pronësi në 25% pjesë takuese të një sipërfaqeje tokë *arë* [në total 10.000 m²], përfituar në zbatim të ligjit nr. 7501/1991 “Për Tokën”. Nga aktet ka rezultuar edhe që në vitin 2014, familja bujqësore, pjesë e të cilës ishte edhe bashkëshorti, ka shitur 6.000 m² tokë kundrejt çmimit 1.758.000 lekë në total. Në këtë

transaksion, personi i lidhur është përfaqësuar me prokurë të posaçme nga nëna e tij. Në konkluzion, Komisioni ka konstatuar se personi i lidhur/bashkëshorti nuk ka deklaruar shitjen e pjesës takuese dhe përfitimin e vlerës financiare prej 439.500 lekësh. Për këtë shkak, në vlerësim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë kryer deklaram të pasaktë, në kundërshtim me parashikimet e shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

10.1. Subjekti i rivlerësimit nuk është dakord me konkluzionin e Komisionit, duke potencuar se bashkëshorti nuk e ka marrë pjesën takuese ende dhe, për pasojë, nuk kishte çfarë të deklaronte. Veprimet janë kryer nga nëna e tij, në cilësinë e përfaqësueses së familjes bujqësore e, për pasojë, edhe kartela ka dalë në emër të saj, sikurse rezulton nga aktet. Pasaktësia për pasurinë e bashkëshortit nuk mund të sjellë si pasojë aplikimin e masës disiplinore ekstreme të shkarkimit nga detyra. Pamjaftueshmëria apo pasaktësia në kuadër të procesit të rivlerësimit lidhen me sjelljen e subjektit, vetëm nëse janë në atë nivel të rëndë shkeljeje të krahasueshëm ose të barabartë me mungesën e burimeve të ligjshme, deklarimin e rremë ose konfliktin e interesit⁶⁵.

10.2. Trupi gjykues e gjen të pabazuar konkluzionin e Komisionit. Në kushtet që këtë pjesë pasurie subjekti e personi i lidhur *nuk* e posedonin më në momentin kur hartuan deklaratën *vetting*, është e pamundur të argumentohet deklaram i pasaktë për një pjesë pasurie tashmë të tjetërsuar. Me fjalë të tjera, deklarimi në deklaratën *vetting* ishte i saktë. *Së dyti*, në kushtet që mosmarrja e përfitimit material, për një transaksion të ndodhur përpara martesës ligjore të subjektit, nuk passjell asnjë pasojë favorizuese për subjektin në procesin e rivlerësimit dhe, shpjegimet për rrethanat mbi të cilat bazohet mosvjelja e pjesës takuese të përfitimit nga shitja nga bashkëshorti apo ngarkimi me përgjegjësi i subjektit, për mosdeklarimin e këtij veprimi nga trupi gjykues i Komisionit, në Kolegj, u vlerësua i pakuptimtë e i pabazuar. Në këto kushte, konkluzioni i Komisionit se subjekti e personi i lidhur kanë bërë deklaram të pasaktë, sipas germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, nuk qëndron. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

10.3. Nga aktet në fashikull rezulton se subjekti dhe bashkëshorti kanë lidhur martesë në datën 30.04.2014. Në deklaratën e parë periodike në cilësinë e personit të lidhur, për vitin 2014, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar ¼ pjesë takuese të tokës “arë”, me sipërfaqe 10.000 m², të regjistruar në emër të nënës së tij. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar njëlloj si në deklaratën periodike dhe ka bashkëlidhur certifikatën e pronësisë. Nga aktet që subjekti ka depozituar në përgjigje të rezultateve të hetimit, në Komision, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka depozituar edhe Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (në vijim “AMTP”) që mban datën 15.07.2006, nga i cili konfirmohet përfitimi në emër të familjes bujqësore e një toke arë me sipërfaqe 16.000 m², në bazë të ligjit nr. 7501/1991. Për këtë pronë janë lëshuar dy certifikata pronësie të datës 14.04.2014, gjithashtu, në emër të vjehrrës së subjektit. Në datën 18.04.2014, përfaqësuesja me prokurë [vjehrra e subjektit] ka shitur 6.000 m², me vlerë 1.758.000 lekë. Në këtë kontratë, është shënuar se *shuma është likuiduar mes palëve jashtë zyrës noteriale*.

10.4. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti në mënyrë konsistente ka pretenduar se personi i lidhur/bashkëshorti nuk ka përfituar të ardhurat nga shitja e kësaj prone⁶⁶. Po ashtu, rezulton

⁶⁵ Subjekti referon edhe vendimin e Kolegjit (JR) nr. 35/2020.

⁶⁶ Në pyetësorin nr. 2: “Theksoj gjithashtu se kjo shumë nuk do të merrej hua nga ana jonë, nëse do të ishte shitur pjesa e tokës që i takon bashkëshortit A. A., në tokën bujqësore fituar në bazë të ligjit nr. 7501 “Për Tokën”,

se shitja ka ndodhur përpara martesës ligjore të subjektit, ndërsa të ardhurat e gjeneruara nuk kanë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie. *Së fundmi*, bashkëshorti i subjektit e ka deklaruar pasurinë që dispononte në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, në përputhje me dokumentacionin. Për gjithë këto aspekte, trupi gjykues vëren se pasaktësia në deklaramin është e pamundur të argumentohet. Për rrjedhojë, ky shkak ankimi u gjet i bazuar, ndërsa pretendimet e tjera të subjektit për këtë pasuri pa peshë përcaktuese, në kushtet që vetë ky shkak për marrjen e masës disiplinore nuk qëndron.

IV. Analiza financiare

11. Vendimi i [shumicës së] Komisionit nuk ka asnjë referencë të analizës financiare. Në arsyetimin e Komisionerit në pakicë, ndër të tjera, pasqyrohet analiza financiare për periudhën 2012-2016, sipas së cilës në vitet 2015 dhe 2016, bilanci financiar familjar i subjektit të rivlerësimit rezulton se është negativ, me një vlerë totale (-) 1.022.161 lekë. Subjekti ankimon rezultatin negativ të bilancit të viteve 2012-2016, të pasqyruar në analizën e anëtarit në pakicë, duke argumentuar se nëse do të korrigjohej zëri për të ardhurat e bashkëshortit, balanca negative do të reduktohej, më tej, në vlerën (-) 825.061 lekë dhe sjellë në zbatim parimin e proporcionalitetit.

11.1. Për shkak të pretendimeve të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit kontrollloi dhe përfundimisht konfirmoi balancën negative të potencuar nga anëtari i trupit gjykues të Komisionit në pakicë, me fokus periudhën 2012-2016. Është me rëndësi të theksojmë që ajo balancë *nuk* mban në konsideratë efektin e dy *huave* të pretenduara si të marra nga prindërit në vitin 2015 dhe 2016, përkatësisht 336.000 lekë dhe 36.000 euro, të cilat rezultuan të paprovuara me dokumentacion ligjor. E thënë ndryshe, analiza e komisionerit në pakicë tregon *vetëm* pamundësinë financiare vjetore të subjektit, për krijimin e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve për vitet përkatëse, përpos pamjaftueshmërisë së burimeve që për shkak të huave të paprovuara, kanë efektin e mungesës së burimeve për krijimin e pasurive konkrete. Pamundësia e krijimit të pasurive, sipas kontrollit në Kolegj, do të përllogaritej rreth 4.000.000 lekë.

11.2. Zëri tjetër i ankimuar në mënyrë të shprehur nga subjekti, përfitimet e bashkëshortit nga punëdhënësi, {***}, përfshirë edhe shpërblime e veshje, është përfshirë nga Komisioni në të ardhurat totale. Përfshirë nga ky zë përbëjnë dietat e shpenzimet për të cilat është arsyetuar më sipër. Për rrjedhojë, edhe në këtë kontekst, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

11.3. Në përmbledhje të kontrollit të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, ajo rezulton me: (i) mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë “apartament me sipërfaqe 80 m², në Tiranë”. Subjekti nuk ka justifikuar me dokumentacion ligjshëm burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e huas nga prindërit në vlerën 36.000 euro dhe pagesën e këstit të fundit prej 2.000 eurosh në datën 24.08.2016; (ii) mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë automjet, të ardhurat nga shitja e së cilit kanë shërbyer si burim për krijimin e automjetit tjetër, objekt deklarimi në deklaratën *vetting*; (iii) mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve në vitet 2015 dhe 2016. Për shkak të gjithë sa më sipër, pretendimi i subjektit për disproporcionalitet të masës së shkarkimit nuk qëndron.

pasuri në bashkëpronësi të tij me familjen. Nëse kjo pasuri e paluajtshme do të shitet më herët në kohë, edhe shlyerja e detyrimit kundrejt prindërve do të realizohet më herët dhe jo pjesë-pjesë”.

C/2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës

12. Pasi ka analizuar raportin e DSIK-së, Komisioni ka konstatuar se informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit janë të bazuara në fakte dhe rrethana konkrete. Komisioni, po ashtu, është shprehur se “edhe nëse ky konkluzion nuk do të ishte i mjaftueshëm”, për të konkluduar për kontrollin e figurës së subjektit, “mospërmbushja e rregullt e detyrës cenon pastërtinë e figurës dhe shkallën e besueshmërisë së saj, në zbatim të pikës 2 të nenit 4 dhe pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016”. Vendimi i Komisionit bazohet në analizën e një çështjeje penale të gjykuar nga subjekti, me vendimin nr. {***}, datë 17.06.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në ngarkim të të pandehurit P. F..

12.1. Subjekti kundërshton në tërësi këtë aspekt të vendimit, duke potencuar, *së pari*, se: (i) gjetjet në vendim *nuk* janë evidentuar në relacionin e rezultateve të hetimit e as në seancën dëgjimore. Ajo kundërshton po ashtu (ii) raportin e DSIK-së në tërësi, duke potencuar se ai nuk përmban të dhëna të besueshme apo fakte konkrete, por konstatime të përgjithshme, subjektive, pa përcaktuar veprimet e paligjshme në të cilat dyshohet se ka ndikuar. Nuk përmendet asnjë kontakt i papërshtatshëm dhe ajo [subjekti] nuk bën pjesë në kategorinë e funksionarëve që vihet nën presion nga struktura kriminale. Konkluzioni për cenim të besimit të publikut, që pasqyron vlerësim nga prokurori, është i paragjykuar, subjektiv, pa asnjë bazë objektive, pasi përbën përpjekje për të gjetur shkaqe për të vendosur masën disiplinore. (iii) Mosnjohja me informacionin e klasifikuar *sekret shtetëror*, përbën cenim të procesit të rregullt ligjor. Faktet që disponohen nga Komisioni janë cilësuar padrejtësisht si *sekret shtetëror*. Komisioni duhet ta kishte informuar lidhur me faktet sipas së cilave ka cenuar besimin e publikut të drejtësia dhe jo me burimin nga rezultojnë ato (ka dhënë shpjegime për z. P. F.). (iv) Komisioni ka tejkalluar kompetencat kushtetuese e ligjore të organeve të rivlerësimit, duke analizuar përmbajtjen dhe themelin e vendimit. Ky konstatim përbën një arsye më vete për të kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Qëndrimi subjektiv i Komisionit, sipas subjektit, shfaqet edhe në analizën e vlerësimit të aftësive profesionale, që në vendim nuk ka evidentuar konkluzionet e Grupit të Punës së KLGj-së.

12.2. Në vlerësim të shkaqeve të ankimit dhe pasi u njoh me informacionin e referuar nga organet ligjzbatuese në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, mbi bazën e të cilit është dhënë vlerësimi, sipas nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, për *papërshtatshmëri* në vijimin e detyrës, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje dy aspekte. *Së dyti*, në kushtet që Komisioni ka konkluduar se subjekti ka arritur nivel *kualifikues* në vlerësimin e aftësisë profesionale, vlerësimi i kryer për çështjen penale të konkluduar prej saj me vendimin e vetëm të marrë në analizë, në rrethanat konkrete, nuk mund të përbëjë cenim të besimit të publikut të drejtësia, pavarësisht nga problematikat e konstatuara në arsyetimin e caktimit të pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë. Për pasojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit për këtë shkak ankimi është i bazuar, ndërsa konkluzioni i Komisionit për cenim të besimit të publikut, për këtë vendim, nuk u gjet i drejtë. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

12.3. *Së treti*, nga aktet rezulton se raporti fillestar i DSIK-së ka ndryshuar duke passjellë konstatimin për *papërshtatshmëri* për vazhdimin e detyrës⁶⁷. Komisioni ka aksesuar informacione të klasifikuara *sekret shtetëror* në mënyrë të drejtpërdrejtë në organet ligjzbatuese

⁶⁷ Shkresë e DSIK-së, nr. {***} prot., datë 09.04.2021, e deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 09.04.2021, të KDZh-së.

që e disponojnë atë. Raporti i dytë, pasqyruar gjerësisht në vendimin e Komisionit⁶⁸, referon se: (i) subjekti është përfshirë në veprime korruptive gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarës; (ii) për subjektin ngrihen dyshime se ka ushtruar ndikim të paligjshëm në disa procese penale; (iii) institucionet verifikuese kanë informuar mbi dyshime për veprimtari të kundërligjshme në sistemin e drejtësisë.

12.4. Në vijim të informacionit të marrë nga organet ligjzbatuese, Komisioni ka kërkuar informacion për çështjet penale që lidhen me dy individë. Përfundimisht, hetimi administrativ i Komisionit është fokusuar me vendimmarrjen e subjektit⁶⁹ për njërin prej tyre, z. P. F.. Katër çështjet që lidheshin me personin tjetër [z. S. F.] ishin gjykuar nga gjyqtarë të tjerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Komisioni ka administruar kopje të dosjes gjyqësore penale me të pandehur P. F..

12.5. Nga aktet rezulton se në çështjen e marrë në analizë, prokuroria ka kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit, i akuzuar/dënuar në veprën penale “*prodhim dhe shitje e narkotikëve*” dhe në bazë të nenit 283/1 të Kodit Penal dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim. Prokuroria i ka kërkuar gjykatës edhe që të ulë dënimin me 1/3 dhe përfundimisht të urdhërojë dënimin me 4 vite e 8 muaj burgim, duke aplikuar kërkesat e nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata, në përfundim të gjykimit, vendosi të deklarojë fajtor të pandehurin, sipas akuzës, dënimin e tij me 6 vite burgim dhe në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të zbatohet dënimi me 4 vite burgim. *Së fundmi*, në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, gjykata/subjekti urdhëroi pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit ,duke e vendosur në provë të pandehurin për një periudhë 5-vjeçare me kusht që gjatë kësaj periudhe të mbajë kontakt me zyrën e provës.

12.6. Subjekti ka arsyetuar se në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal⁷⁰ për pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim [gjykata] ka mbajtur parasysh: (a) rrezikshmërinë e autorit, ku gjatë gjykimit nuk rezultoi se i pandehuri të jetë dënuar më parë për kryerjen e ndonjë vepre penale; (b) i pandehuri ka përgjegjësi thelbësore familjare, pasi ka 5 fëmijë, 4 të mitur dhe kanë të domosdoshme përkujdesjen e tij, fakt ky i provuar nga certifikata familjare; (c) gjendjen e vështirë, pasi edhe bashkëshortja e tij është e papunë dhe merr familjarisht ndihmë ekonomike në masën 7.920 lekë/muaj vërtetuar nga Bashkia e Vaut të Dejës; dhe (ç) në cilësinë e kryefamiljarit do ketë mundësi të punësohet pranë subjektit “{***}”, me objekt “bar-kafe”, i cili mori përsipër punësimin e tij provuar ky fakt me deklaratë noteriale. Ndaj vendimit të mësipërm, ushtroi ankim prokurori. Fokusi i ankimit është kryesisht aplikimi i nenit 59 të Kodit Penal, nëpërmjet të cilit i pandehuri u vendos në provë.

12.7. Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës dhe, në përfundim, konstatoi se nuk ishin përmbushur rrethanat e zbatimit të nenit 59 të Kodit Penal, që justifikojnë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim, si ato që lidhen me moshën, kushtet shëndetësore dhe nevojat familjare. I pandehuri është i ri dhe me rrezikshmëri shoqërore, nuk u vërtetuan kushtet

⁶⁸ Vendimi i Komisionit, paragrafët 128-130.

⁶⁹ Vendimi i marrë nga subjekti me nr. {***}/2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁷⁰ “[I.] Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë, vjet, mund të urdhërojë, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale. 2. Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi. 3. Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata. [...]”.

shëndetësore për pamundësinë e vuajtjes së dënimit dhe nevojat familjare mund të përmbushen nga anëtarët e familjes, ndonëse i pandehuri kishte fëmijë të mitur. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se, në bazë të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka kryer *mospërmbushje të rregullt të detyrës*, duke cenuar kështu besimin e publikut te drejtësia.

12.8. Subjekti ka parashtruar argumentet që ka ngritur në ankim edhe pasi është njohur me rezultatet e hetimit më 10.05.2021. Sikurse në ankim, edhe në atë fazë të hetimit administrativ, subjekti ka analizuar përse në çështjen konkrete gjenin zbatim parashikimet për pezullim të dënimit, sipas nenit 59 të Kodit Penal.

12.9. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar pjesërisht e kontradiktor pretendimin e subjektit për mosnjohjen me gjetjet e Komisionit në vendim. Subjektit i është kaluar barrë prove për përmbushjen nga i pandehuri të kriterëve procedurale për pezullim të dënimit dhe kohë prove⁷¹, është njohur me aktet e dosjes së Komisionit në versionin elektronik⁷², i është pranuar edhe kërkesa për kohë shtesë deri më datë 03.06.2021, si dhe është shtyrë seanca dëgjimore më 09.06.2021. Po ashtu, vendimi nuk duket të ketë të dhëna të panjohura për subjektin, për të cilat nuk ka mbajtur qëndrim. Subjekti ka sqaruar me detaje rrethanat që, sipas saj, në rastin e vendimit të z. P. F., plotësoheshin për të aplikuar zëvendësimin e dënimit me burgim, me shërbim prove.

12.10. Nga sa më sipër, trupi gjykues prezumon se pretendimet e subjektit për moskalim barre prove lidhen me *mënyrën* sesi Komisioni ka kategorizuar këto gjetje – si cenim të besimit të publikut -- dhe jo me thelbin e tyre për të cilin ajo ka dhënë shpjegime të detajuara. Duke abstraguuar nga fakti që klasifikimi i materialit të konsultuar nga Komisioni si *sekret shtetëror*, nuk është tagër e Komisionit, pyetjet që i janë drejtuar subjektit kanë qenë në përputhje me detyrimet ligjore që normojnë këtë kategori informacioni, duke i dhënë njëkohësisht edhe subjektit mundësi për t'u mbrojtur e paraqitur kundër argumentet e saj, që përmbush edhe detyrimin për hetim të pavarur nga organet e rivlerësimit. Për pasojë, ky pretendim i subjektit është i pabazuar, ndonëse nën dritën e konkluzionit të trupit gjykues, jo përcaktues në rrethanat konkrete.

12.11. Në këtë kuadër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka kryer hetim të pavarur dhe rezultatet e raportit të DSIK-së dhe KLGj-së kanë përbërë pikënisje/indicie për një hetim të thelluar për të dy kriteret respektive, përfshirë edhe vlerësimin profesional të subjektit, duke pasqyruar konstatimet e Grupit të Punës së KLGj-së. Kontrolli që kryhet në procesin e rivlerësimit, përfshirë edhe atë të figurës, është i ndryshëm nga hetimi penal duke qenë tërësisht administrativ. Po ashtu, informacioni i dërguar nga Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar⁷³ konfirmonte që ndaj subjektit të mos ishte regjistruar ndonjë procedim penal, raporti i DSIK-së ishte i mëpasmë në kohë. Për këtë arsye, dhe meqenëse hetimi në rivlerësim nuk ka natyrë penale, këto dy pikënisje me të dhëna të ndryshme jo domosdoshmërisht e kufizojnë Komisionin në kryerjen e verifikimeve kontrollin e figurës.

⁷¹Referuar rezultateve të hetimit, Komisioni ka ftuar subjektin të japë komente dhe shpjegime të detajuara, shoqëruar me prova shkruesore, në lidhje me çdo konstatim në raportin e DSIK-së duke u shprehur që: “Bazuar në raportin e DSIK-së, Komisioni ka bërë hetime të mëtejshme duke kërkuar dosjet përkatëse të cilat janë analizuar tek kriteri i vlerësimit profesional”.

⁷² Në datën 14.05.2021, subjekti i rivlerësimit është njohur dhe ka tërhequr pranë Komisionit kopje me CD, të gjithë dokumentacionit të dosjes së vënë në dispozicion. Shënimi sipas deklaratës së nënshkruar nga subjekti.

⁷³ Shkresë e SPAK me nr. {***} prot., datë 18.02.2021, sipas së cilës deri në atë moment nuk kishte nisur ndonjë hetim në lidhje me dyshimet rreth subjektit për korrupsion.

12.12. Për rrjedhojë, pretendimi se mospasqyrimi në vendim i rezultateve të organeve të prokurorisë për pastërtinë e figurës, përbën subjektivitet të Komisioni, nuk qëndron. Për të njëjtat shkaqe, pavarësisht se nuk ka një vendim përfundimtar për këtë rast nga Gjykata e Apelit Shkodër, hetimi i Komisionit nuk është në tejkalim të kompetencave, pasi është bërë mbi bazën e indicieve të organeve ndihmëse⁷⁴. Për rrjedhojë, edhe pretendimi i subjektit për mungesë paanësie nga trupa gjykuese e Komisionit, bazuar në sa më sipër, sikurse arsyetohet gjerësisht në analizën e pretendimeve me natyrë procedurale, që ngrihet për herë të parë në ankim, nuk qëndron.

12.13. Nga ana tjetër, në kushtet që Komisioni ka konkluduar se subjekti ka arritur nivel *kualifikues* në vlerësim të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar konkluzionin për cenim të besimit të publikut për të njëjtin kriter. E thënë ndryshe, në kushtet që Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka zbatuar gabim kriteret e nenit 59 të Kodit Penal do të duhej që, më së paku, ky konstatim të mbahej në konsideratë në vlerësimin profesional, pikësëpari, ndërsa mënyra sesi ai [konstatimi] ndikon në vlerësimin përfundimtar mund t'i nënshtrohej një analize përfundimtare, sipas diskrecionit të trupit gjykues. Vetëm në zbatim të këtyre hapave, duke pasur në konsideratë që flitet për një çështje të vetme, sikurse edhe që gjejnë zbatim edhe rrethana të tjera që lidhen me burimin, saktësinë, provueshmërinë e të dhënave dhe të drejtën e subjektit për t'u mbrojtur si parakusht apo përgjegjësinë që ka/duhet të kishte ajo personalisht, konkluzioni i Komisionit do të paraqitej i bazuar dhe i mirëargumentuar.

12.14. Nga ana tjetër, konkluzioni i Komisionit nuk është pasojë e një analize për mënyrën sesi do të duhet të merrnin peshë indiciet e organeve ndihmëse për ndikim të paligjshëm për “disa” çështje penale apo *korrupsion sistematik*, ndonëse flitet për një çështje për të cilën subjekti është mbrojtur. Po ashtu, vendimi i Komisionit duket i bazuar kryesisht në ankimin e prokurorit, i cili nuk i ishte nënshtuar ende kontrollit të Gjykatës së Apelit. Për sa më sipër, këto rrethana që rezultojnë nga aktet dhe nga analiza e sipër referuar u vlerësuan nga trupi gjykues i Kolegjit të pamjaftueshme për të arritur në konkluzionin për cenim të besimit të publikut nga subjekti.

13. Në përfundim, në analizë të shkaqeve të ankimit, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk arritën të provojnë se personat e tjerë të lidhur kishin mundësinë të financonin me burime të ligjshme huan në vitin 2016, për blerjen nga subjekti të pasurisë objekt analize “*apartment banimi me sipërfaqe 80 m², në Tiranë*”, ashtu sikurse edhe të automjetit “Daimler Chrysler” prodhim i vitit 2003. Në këto kushte, pas reflektimit të konkluzioneve të sipërcituara, nën dritën e pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për sa më lart, vendimi nr. 398, datë 11.06.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është i mbështetur në ligj e në prova dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

⁷⁴ Çështja ka qenë në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit Shkodër në kohën kur ka kërkuar informacion Komisioni, referuar shkresës nr. {***} prot., datë 05.03.2021.

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 398, datë 11.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Luveda Dardha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 14.10.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi